




---

# **ANALIZA E CILËSISË DHE BARAZIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE NË FUSHËN JURIDIKE PENALE**





---

**ANALIZA  
E CILËSISË DHE  
BARAZIMIT TË VENDIMEVE  
GJYQËSORE NË FUSHËN  
JURIDIKE PENALE**

## ANALIZA E CILËSISË DHE BARAZIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE NË FUSHËN JURIDIKE PENALE

Titulli origjinal i publikimit:  
АНАЛИЗА НА КВАЛИТЕТ И ВОЕДНАЧЕНОСТ  
НА СУДСКИТЕ ОДЛУКИ ВО КРИВИЧНО-ПРАВНАТА ОБЛАСТ

Botues:  
Instituti për politikë evropiane - Shkup  
Asociacioni për iniciativa zhvillimore - Zenit Shkup

Redaktor:  
Prof. Dr. Jovan Ananiev

Autore:  
Natali Petrovska

Lektor:  
Dejan Vasilevski

Përkthim nga gjuha maqedone në gjuhën shqipe:  
Orhan Kadrievski

Disenji dhe shtypi:  
Relativ

Shkup, Korrik 2021

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343:347.95(497.7)(047)

PETROVSKA, Natali

Analiza e cilësisë dhe barazimit të vendimeve gjyqësore në fushën juridike penale [Електронски извор] / [autore Natali Petrovska ; përkthim nga gjuha maqedone në gjuhën shqipe Orhan Kadrievski]. - Shkup : Instituti për politikë evropiane : Zenit, 2021

Начин на пристапување (URL): <https://epi.org.mk/post/17486?lang=sq>. - Превод на делото: Анализа на квалитет и воедначеност на судските одлуки во кривично-правната област. - Текст во PDF формат, содржи 67 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 12.09.2021. - Фусноти кон текстот. - Содржи и: Aneksi

ISBN 978-608-4702-11-5 (Институт за европска политика)

ISBN 978-608-4758-11-2 (Zenit)

a) Кривично право -- Судски одлуки -- Македонија -- Извештаи

COBISS.MK-ID 54925573



Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Partneriteti Justicija – kthimi i besimit të qytetarëve", i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Sektorit për financim qendror dhe lidhje të marrëveshjeve në Ministrinë e Financave në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe assesi nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet dhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

# PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	6
HYRJE	7
CILËSIA E VENDIMEVE	10
1. ANALIZA E CILËSISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE NË FUSHËN E SË DREJTËS PENALE	11
1.1 Metodologjia	12
1.2 Karakteristikat e ekzemplarit për analizë	13
1.3 Analiza e cilësisë së vendimeve gjyqësore në nivelin e rajoneve të apelit	14
1.3.1 Cilësia e vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit në Manastir	15
1.3.2 Cilësia e vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit në Gostivar	21
1.3.3 Cilësia e vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit në Shkup	26
1.3.4 Cilësia e vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit në Shtip	32
1.4 Analiza e cilësisë së vendimeve gjyqësore në nivelin nacional	37
1.4.1 Analiza sasiore	37
1.4.2 Analiza cilësore	37
REKOMANDIMET	41
BARAZIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE – STUDIMI I RASTIT	45
Vërejtjet hyrëse	47
Faktet rreth rasteve	49
Çështja juridike	54
Procedura gjyqësore – argumentimi i gjykatave	57
KONKLuzioni	61
ANEKSI	65

## PARATHËNIE

Kjo analizë është bërë brenda projektit "Partneriteti Justicia: Kthimi i besimit të qytetarëve", që e zbatojnë Instituti për politikë evropiane dhe Asociacioni ZENIT, financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti synon të kontribuojë për kthimin e besimit të qytetarëve në sektorin e drejtësisë maqedonase përmes përfshirjes së rëndësishme të shoqërisë civile në reformat thelbësore. Përfituesit përfundimtarë të këtij projekti janë institucionet në fushën e drejtësisë. Qëllimi i kësaj analize është të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore në fushën e të drejtës për kundërvajtje, të vetë procedurës me qëllim që t'iu përgjigjet pritjeve të qytetarëve në lidhje me të drejtën për një gjykim fer dhe të drejtë si dhe për qasje në drejtësi.



**HYRJE**

Në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), garancitë e parashikuara në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) përfshijnë obligimin që gjykata të mundësojë dhe të prodhojë arsytetime përkatëse dhe të mjaftueshme në vendimet e saj gjyqësore. E drejta për vendimet e arsyetuara është komponenti kryesor i drejtësisë së diskutimit që bazohet në praktikën e GJEDNJ-së dhe kjo bazohet pikërisht në disa parime të përgjithshme të përfshira në KEDNJ, të cilat në këtë mënyrë mbrojnë individin nga arbitrariteti i institucioneve.<sup>1</sup> Bazuar në këtë, vendimet është e domosdoshme të përmbajnë arsye që do të ishin të kënaqshme në mënyrë që vendimi gjyqësor të bazohet në to, por edhe t'u përgjigjet aspekteve thelbësore që palët në procedurë i vendosin si argumente të tyre juridike. Kjo e drejtë nuk është formuluar në mënyrë eksplicite në tekstin e nenit 6 të Konventës, por paraqet të drejtën hetimore që në thelb i garanton të gjitha të drejtat materiale. Vendimet e arsyetuara lënë përshtypje, por edhe fusin siguri tek palët se rasti i tyre vërtet ishte shqyrtuar, analizuar dhe procesuar në mënyrë përkatëse. Sidoqoftë, ato kontribuojnë edhe në avancimin e besimit publik në vendimmarrjen gjyqësore, ndërsa në mënyrë plotësuese ofrojnë edhe bazë të qëndrueshme për sundimin e së drejtës. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore është me rëndësi të veçantë, duke pasur parasysh se kontribuon edhe në fitimin e besimit publik në drejtësinë e drejtë, objektive dhe transparente si shtylla të shoqërisë demokratike.<sup>2</sup>

Megjithëse gjykatat kanë mundësinë, bazuar në bindjen<sup>3</sup> e tyre të lirë gjyqësore, t'i zgjedhin provat dhe argumentet mbi të cilat e mbështesin vendimin e tyre, ato janë të detyruar të japin arsyetim përkatës për (pa)zbatueshmërinë e tyre. Si rrjedhojë, dispozitat nga neni 6 të KEDNJ-së nuk mund të kuptohen si të detyrueshme, dhe as GJEDNJ-ja nuk tregon se është e domosdoshme të argumentohet secili qëndrim individual, përkatësisht provë në procedurë.<sup>4</sup> Thellësia dhe shtrirja e arsyetimit të tyre mund të ndryshojë nga lloji i vendimit, nga lloji i kompetencës së gjykatës, por edhe nga rasti në rast. Në bazë të kësaj, gjykatat është e domosdoshme t'i shqyrtojnë pretendimet kryesore të pjesëmarrësve në procedurën që hasen si në të drejtën e brendshme materiale dhe hetimore, ashtu edhe me të drejtat dhe liritë e garantuara nga KEDNJ-ja. Arsyetimet në asnjë rast nuk nënkuptojnë ritregimin e ngjarjes juridike-penale, si dhe të të gjitha veprimeve të ndërmarra në procedurë, që padyshim do të çonin në atë që vendimet gjyqësore të jenë shumë të gjata. Si rrjedhojë, është plotësisht e gabuar praktika e disa gjykatave për të krijuar kompilime nga procesverbalet gjyqësore nga seancat e mbajtura gjyqësore për diskutimin kryesor. Vendimet gjyqësore janë të domosdoshme, por edhe sugjerohen nga GJEDNJ-ja, për të qenë sa më konsistentë të jetë e mundur dhe të liruar nga detajet e panevojshme dhe eksplikimet akademike.

1 Lënda Roche kundër Britanisë së Madhe, nr. 32555/96, § 116, tetor 2005, GJEDNJ.

2 Lënda Suominen kundër Francës, nr. 37801/97, § 37, 1 korrik 2003; Tatishvili kundër Rusisë, nr. 1509/02, § 58, janar 2007, GJEDNJ.

3 Neni 16 i LPP-së.

4 Lënda Van de Hurk kundër Holandës, § 61, nr. 16034/90; 19 prill 1994, GJEDNJ.



Në teorinë juridike, arsyetimet përshkruhen si arsytetime të teorisë juridike dhe arsytetime për transparencë. Kur bëhet fjalë për procedurat para gjykatave të shkallës së dytë, arsyetimet e dhëna duhet të jenë në përputhje, por edhe të mundësojnë përdorimin efikas të konceptit të garantuar me Kushtetutë të "së drejtës së ankesës"<sup>5</sup>, që teorikisht përshkruhet si orientim funksional. Gjykatat e shkallës së dytë mund të kenë edhe arsytetime më të shkurtra sesa gjykatat e shkallës së parë, por ato duhet t'i adresojnë, përkatësisht t'u përgjigjen argumenteve kryesore të ngritura nga palët në procedurë.

Vendimet gjyqësore duhet të hartohen në gjuhë të arritshme, të thjeshtë dhe të qartë, ato duhet të argumentohen, të bëhen publike brenda afatit të arsyeshëm dhe të bazohen në diskutim të drejtë dhe publik.<sup>6</sup> Në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së, arsyetimet duhet të përmbajnë argumente në lidhje me pohimet vendimtare dhe kryesore, aspektet dhe pretendimet që ishin thelbësore për miratimin e vendimit në drejtim të caktuar.<sup>7</sup> Si rrjedhojë, kjo gjykatë do të konstatojë shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, gjithnjë kur gjykatat vendase në arsyetimin e vendimit do të injoronin çështje apo argument konkret, relevant dhe të rëndësishëm të ngritur nga kërkuesi gjatë procedurës.<sup>8</sup> Aktgjykimet e arsyetuara u përgjigjen pyetjeve me rëndësi vendimtare për lëndën (Mugoša kundër Malit të Zi), japin arsyetim të hollësishëm në lëndët ku ligji nuk është mjaft i qartë (Milojević kundër Serbisë) dhe aty ku gjendja faktike nuk është e qartë ose konsekuente (Hirvisaari kundër Finlandës, Atanasovski kundër R.P. e Maqedonisë), mbajnë konsideratë për specifikat e sistemit juridik (Taxquet kundër Belgjikës), por edhe kërkojnë arsytetime më pak të hollësishme të gjykatave të apelit kur aktgjykimet e gjykatave themelore janë proceduar mirë (Garcia Ruiz kundër Spanjës).<sup>9</sup>

5 Lënda Hadjianastassiou kundër Greqisë, nr. 12945/87, 16 dhjetor 1992, GJEDNJ.

6 Magna Carta of Judges, Fundamental Principles, Strasburg, nëntor 2010.

7 Lënda Boldea kundër Rumanisë, § 30, nr. 19997/02, 15 shkurt 2007; Moreira Ferreira kundër Portugalisë, § 84, nr. 19867/12, 11 korrik 2017; Papon kundër Francës, nr. 54210/00, 25 korrik 2002; Hadjianastassiou kundër Greqisë, nr. 12945/87, 16 dhjetor 1992, GJEDNJ.

8 Lënda Nechiporuk and Yonkalo kundër Ukrainës, § 280, nr. 42310/04, 21 prill 2011; Rostomashvili kundër Gjeorgjisë, § 59, nr. 13185/07, 8 nëntor 2018, Zhang kundër Ukrainës, § 73, nr. 6970/15, 13 nëntor 2018, GJEDNJ.

9 Mirjana Lazarova Trajkovska, "Argumentimi juridik dhe arsyetimi i aktgjyqimeve", Shkup, nëntor 2019.

## CILËSIA E VENDIMEVE

Cilësia e vendimeve gjyqësore varet jo vetëm nga gjykatësi individual që merret me lëndën, por edhe nga numri i konsiderueshëm i faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm, për shembull: cilësia e legjislacionit, resurset adekuate në dispozicion të sistemit të jurisprudencës, cilësia e avancimit profesional të gjykatësve, profesionalizmi i gjykatësve, efikasiteti i tyre, parimi i punës dhe mënyra e mbajtjes së procedurës.

Kur bëhet fjalë për perceptimet në lidhje me cilësinë e vendimeve gjyqësore të miratuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kreatorët e tyre, ndërsa si pjesë e grupit target në kuadër të hulumtimit të kryer në shkurt 2019<sup>10</sup>, 7.1%, përkatësisht 10.4% vlerësuan si të pamjaftueshme, përkatësisht të mjaftueshme, më saktë gjithsej 17.5% ose diçka më pak se një e pesta e gjykatësve konsiderojnë se cilësia e vendimeve gjyqësore është në nivel të ulët. Në masë të konsiderueshme, gjykatësit konsiderojnë se cilësia e vendimeve gjyqësore është e mirë (42.4%), përkatësisht shumë e mirë (27.6%), ndërsa me notë të shkëlqyeshme, cilësia u vlerësua nga vetëm 12.5% e gjykatësve. Si pjesë e të njëjtit hulumtim, avokatët dhe prokurorët përfshihen si grupe target. Pra, vlerësimet nga këta pjesëmarrës në procedurat, dhe veçanërisht avokatët, në pjesën dominuese tregojnë pamjaftueshëm (44.7%) dhe mjaftueshëm (29.2%), ndërsa prokurorët kryesisht konsiderojnë se cilësia është e mirë (43.7%), ndërsa pothuajse 40% konsiderojnë se është e mjaftueshme, përkatësisht e pamjaftueshme (27.8, përkatësisht 11.9%).

10 Lidija Stojkova Zafirovska, Zharko Aleksov, Aleksandar Goxho, "Raporti i parë nacional nga bërthama e indikatorëve për matjen e performancave dhe reformave në jurisprudencë", Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike, Shkup 2019.



1

**ANALIZA E CILËSISË SË  
VENDIMEVE GJYQËSORE NË  
FUSHËN E SË DREJTËS PENALE**

Vendimi si kategori e aktit juridik është nocion i përgjithshëm për çdo lloj veprimi nga organet që marrin pjesë në procedurë, pavarësisht faktit nëse bëhet fjalë për vendimmarrje meritore në procedurë ose për vendimmarrje hetimore-formale.<sup>11</sup>

Në kuadër të materies juridike-penale, Ligji për procedurë penale dallon dhe parasheh katër lloje të vendimeve - aktgjykimin, aktvendimin, urdhrin dhe urdhrin penal, përkatësisht aktgjykimin me të cilin lëshohet urdhri penal. Duke pasur parasysh faktin se aktgjykimi është ekskluzivisht vendim gjyqësor, me të cilën zgjidhet lënda në veprim, në bazë të seancës së mbajtur kryesore në gjykatë, nga fillimi i saj deri në përfundim, dhe kështu lëndë e vlerësimit në të janë të gjitha provat dhe argumentet e paraqitura gjatë procedurës, lëndë e evalvimit për nevojat e kësaj analize ishin ekskluzivisht aktgjykimet gjyqësore. Sidoqoftë, duke pasur parasysh që me format e veçanta të aktgjykimeve, të tilla si aktgjykimi i miratuar në bazë të propozim-marrëveshjes<sup>12</sup> dhe aktgjykimi me të cilin gjykata, në bazë të propozimit të prokurorit publik, lëshoi urdhër penal<sup>13</sup>, vendoset pa mbajtur seancë kryesore, por këtu janë edhe aktgjykimet pas pranimit të fajit të akuzuarve, në të cilat provat zvogëlohen dhe paraqiten vetëm provat relevante për sanksion, ky lloj aktgjykimesh nuk u morën në konsideratë për t'u shqyrtuar.

## 1.1 METODOLOGJIA

Për nevojat e kësaj analize, u hartua metodologjia për analizën e cilësisë së vendimeve gjyqësore, si dhe barazimi i tyre, bazuar në konceptet e përgjithshme dhe teorinë e së drejtës, logjikën si shkencë, burimet shkencore, punimet dhe publikimet profesionale, aktet juridike dhe intervistat me profesionistë të fushës, të fushës akademike, si dhe të administratës shtetërore.

Kuadri metodologjik përbëhej nga indikatorët përmes të cilëve vlerësohej cilësia e vendimeve, si në gjykatat e shkallës së parë, ashtu edhe në gjykatat e shkallës së dytë. Ai u nda në tre grupe të mëdha indikatorësh që për gjykatat themelore përfshinin strukturën përkatëse dhe koherencën e vendimeve, logjikën juridike të tyre, përkatësisht nëse respektoheshin ligjshmëritë logjike të miratimit të vendimeve, si dhe cilësia e arsyetimit të vendimeve gjyqësore - ratio decidendi, duke prezantuar lëndën dhe historikun e çështjes që diskutohet, analizën e gjendjes faktike dhe procedurën e provës, qëndrueshmërinë e arsyetimit dhe gjuhën e përdorur, përmes indikatorëve të zhvilluar posaçërisht.

Derisa indikatorët për vendimet e shkallës së dytë vlerësuan nëse ka udhëzime të qarta për gjykatën themelore në rast të kthimit eventual të vendimit për rishqyrtim, arsyet e shprehura qartë për shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës

11 Komentimi i LPP-së.

12 Neni 490 i LPP-së.

13 Neni 499 i LPP-së.

së parë, nëse ka ndryshim të vendimit për sanksion, nëse dhe në çfarë mase jepet argumentimi përkatës për këtë, shqyrtimi i ankesave, arsyetimi i vendimit në drejtim të të gjitha ankesave, struktura përkatëse për ndryshimin dhe hartimin e vendimit të ri, si dhe vëmendja e duhur për rrjedhën e periudhës kohore në lidhje me parashkrimin e lëndëve.

Kuantifikimi i këtyre indikatorëve u determinua paraprakisht në përputhje me standardin e caktuar për vlerësimet, që parashikonte mundësinë që indikatorin mos t'i referohej vendimit gjyqësor konkret dhe të jetë i pazbatueshëm, në bazë të të cilit ai do të merrte notë vlerësuese; më tej, nota "një" si nota më e ulët, e cila është përcaktuar si indikator që nuk mund të gjendet në vendimin gjyqësor, ndërsa është e përshtatshme për vendimin gjyqësor konkret; nota "zero", që u përcaktua për indikatorët që njihen si element në vendimin gjyqësor, por nuk i përmbush standardet minimale të cilësisë; nota "një", e cila është aplikuar për përmbajtjen e njohur që korrespondon me indikatorin, por është aplikuar cilësia e ulët; nota "dy" e zbatueshme për përmbajtjen e përcaktuar që korrespondon me indikatorin për të cilin jepet nota mesatare; dhe nota "tre" me të cilën vlerësohej indikatorin, përmbajtja e përcaktuar e së cilës korrespondon me indikatorin për të cilën jepet nota më e lartë. Vlera e indikatorëve është marrë në mënyrën që të ishte produkt i vlerësimit të indikatorit dhe koeficientit të parashikuar paraprakisht për secilin prej indikatorëve (shih aneks Bashkëngjitjen 1-a dhe Bashkëngjitjen 1-b), i cili ndryshonte në varësi të kompleksitetit dhe rëndësisë së indikatorit. Indikatorët më të ulët ishin përcaktuar ata që janë më pak kompleksë dhe më pak të rëndësishëm dhe anasjelltas. Ndërsa, indeksi i cilësisë së çdo vendimi gjyqësor individual është herës që merret pasi shuma e përgjithshme e vlerave të të gjithë indikatorëve të zbatueshëm do të ndahet me numrin e indikatorëve të zbatueshëm për të cilët jepet vlerësimi.

## 1.2 KARAKTERISTIKAT E EKZEMPLARIT PËR ANALIZË

Për nevojat e kësaj analize, lëndë e shqyrtimit dhe vlerësimit cilësor ishin 61 aktgjykime të miratuara nga gjykatat themelore dhe të apelit në vend. Konkretisht, janë analizuar 41 aktgjykime të gjykatave themelore, nga të cilat: 15 të Gjykatës Themelore Penale në Shkup, 10 të Gjykatës Themelore në Manastir dhe nga 8 të Gjykatës Themelore në Shtip dhe Gjykatës Themelore në Gostivar, si dhe 20 aktgjykime të gjykatave të apelit, nga të cilat: 7 të Gjykatës së Apelit në Shkup, 5 të Gjykatës së Apelit në Manastir dhe nga 4 të Gjykatës së Apelit në Shtip dhe Gjykatës së Apelit në Gostivar. Nëse do ta shpërndanim këtë sipas rajoneve të apelit, situata do të ishte si vijon - 22 aktgjykime nga rajoni i Shkupit, 15 nga rajoni i Manastirit dhe nga 12 rajoni i Shtipit, përkatësisht rajoni i Gostivarit, pavarësisht shkallës në të cilën u miratua vendimi.

Vendimet e analizuara gjyqësore datojnë nga periudha kohore 2017 deri në 2020, dhe ato u zgjedhën me zgjedhje të rastësishme nga baza e aktgjykimeve të disponueshme në faqen e internetit sud.mk, faqja zyrtare integrale e të gjitha gjykatave në vend, të mbajtur nga Gjykata Supreme e RMV-së, si dhe nga platforma elektronike për aktet juridike dejure.mk. Gjatë zgjedhjes së vendimeve, vëmendje e veçantë i është kushtuar periudhës kohore nga e cila datojnë aktgjykimet, më saktë, vendimet nga vitet e ndryshme janë zgjedhur brenda intervalit të caktuar kohor, por gjithashtu i është kushtuar vëmendje edhe larmisë së tyre për sa i përket përgatitjes së tyre nga gjykatës të ndryshëm, këshilla, etj.

## 1.3 ANALIZA E CILËSISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE NË NIVELIN E RAJONEVE TË APELIT

Në përputhje me Ligjin për gjykata, në sistemin gjyqësor, pushteti gjyqësor në RMV ushtrohet nga gjykatat themelore, gjykatat e apelit, Gjykata Administrative, Gjykata e Lartë Administrative dhe Gjykata Supreme. Ndërsa gjykatat themelore themelohen për një ose më shumë komuna, rajoni i të cilave përcaktohet me këtë ligj, gjykatat e apelit themelohen për rajonin e disa gjykatave të shkallës së parë të përcaktuara me ligj. Bazuar në këtë sistemim të sistemit gjyqësor, dhe duke pasur parasysh që të katër rajonet e apelit ishin cak i zgjedhjes së vendimeve, përveç analizës së vendimeve nga këto rajone gjeografike konkrete - Shkupi, Manastiri, Shtipi dhe Gostivari, përmes zgjedhjes së vendimeve nga gjykatat e apelit, indirekt u analizua edhe puna e gjykatave të tjera nga ato rajone të apelit.

### 1.3.1 Cilësia e vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit në Manastir

Grupi i parë i indikatorëve që parashihen në metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore ofron indikatorë në lidhje me strukturën dhe koherencën e vendimit gjyqësor. Sipas vendosjes së tyre, lëndë e analizës ishte fakti nëse vendimet i përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm, pjesë të të cilave janë të përbërë dhe nëse janë të strukturuar siç duhet, nëse shqiptimet e vendimeve janë qartë koncize, si dhe nëse ato janë në harmonizim logjik me arsyetimin, më saktë nuk janë në kundërshtim të ndërsjellë.

Gjatë evalvimit të zbatuar të aktgjykimeve të gjykatave themelore nga ky rajon i apelit, u përcaktua që të gjitha aktgjykimet e zgjedhura për vlerësim, përmes prizmit të indikatorit për strukturën e saktë të aktgjykimit, pa përjashtim, aspak nuk devijojnë nga standardet e parashikuara. Vetëm në dy raste u konstatua shqiptimi i tepruar, i cili është rezultat i përshkrimit identik të dispozitivit të akuzës, kështu që shqiptimi i aktgjykimit nuk devijon nga standardi i qartësisë, por mungon konciziteti i tij. Kjo është kryesisht për shkak të përshkrimit të vëllimshëm të veprës dhe rrethanave nën të cilat është kryer, ndërsa janë theksuar detajisht në aktakuzë, kështu që replikimi i përmbajtjes identike kontribuoi në koncizitetin e pamjaftueshëm të aktgjykimit në pjesën e dispozitivit të tij, ku vlerësimi në pajtim me këtë indikator përcaktohet në 5.6 nga 6.

Asnjë nga aktgjykimet e shqyrtuara nuk devijon nga parimi i koherencës, më saktë, në asnjërin prej tyre nuk u konstatua gjendja në të cilën shqiptimi i aktgjykimit nuk është në harmonizim logjik me arsyetimin ose në kundërshtim të ndërsjellë. Prandaj, për sa i përket këtij indikator, vlerësimi mesatar i aktgjykimeve është më i larti që parashikohet - 6.

Metodologjikisht, tërësia tjetër e indikatorëve i referohet logjikës juridike. Në rastin konkret, lënda e përcaktimit është nëse subsumcioni është kryer siç duhet, më saktë nëse gjendja faktike konkrete e përcaktuar në aktgjykimet, duke zbatuar normat përkatëse dhe të zbatueshme juridike për rastin konkret, prodhon veprime juridike. Gjatë vendosjes së tillë, shqiptimi i aktgjykimit do të ndikonte në përmbajtjen e arsyetimit, që domosdoshmërisht duhet të dalë dhe të bazohet në shqiptimin, por është po aq e rëndësishme që ajo të jetë në përputhje me përmbajtjen e shqiptimit, më saktë që ato të mos jenë në kundërshtim të ndërsjellë. Arsyetimet e aktgjykimeve duhet të jenë koherente dhe të formojnë harmonizim logjik, përkatësisht argumentim të gjerë të dispozitivit të aktgjykimit, të procedurës që pasoi dhe çoi në miratimin e vendimit, si dhe rregullave të gjykimit gjyqësor në rastin konkret.

Kriteret e vendosura në mënyrë të tillë për përcaktimin e përmbushjes së këtij indikator supozojnë përshkrim në lidhje me pohimet faktike të palëve në procedurën për gjendjet faktike konkrete në të cilat kanë ndodhur ngjarjet juridike-penale, procedurën e propozimit dhe realizimit, por edhe zgjedhjen dhe kategorizimin përkatës të fakteve të domosdoshme nga faktet kontestuese, si dhe vlerësimin e provave gjatë procedurës.

Analiza e aktgjykimeve në këtë rajon të apelit tregon se në një pjesë dominuese të tyre nuk ka arsyetim të duhur të rregullave juridike, që të mund së bashku me gjendjen faktike të përcaktohet shqiptimi i aktgjykimit. Parimi i vendosur në metodologjinë e lidhjes së premisë së vogël dhe të madhe, përkatësisht procesi i vlerësimit të provave nga i cili del premisa e vogël, më saktë kualifikimi juridik i fakteve ose përcaktimi i gjendjes faktike, duke zgjedhur normat juridike, lidhjen e tyre, përcaktimin e përmbajtjes dhe interpretimit ose preminë e madhe, nuk mund të identifikohet plotësisht. Bazuar në gjendjen e përcaktuar në këtë mënyrë, ky rajon i apelit, në pajtim me këtë indikator, ka vlerësim mesatar prej 6.9 nga gjithsej 9.

Grupi i fundit dhe më i gjerë i indikatorëve që i parashikon metodologjia për vlerësimin e cilësisë i referohet cilësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, përkatësisht ratio decidendi. Komplexiteti i këtij grupi të indikatorëve do të thotë - hyrje dhe shpjegimi i historikut të çështjes që është lëndë e përcaktimit, aktivitetet që gjykata i ndërmori në veprimin e saj për lëndën konkrete, prezantimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore relevante dhe parimeve juridike, përcaktimi i gjendjes faktike dhe përshkrimi i fakteve materiale, si dhe zbatimi i parimeve ligjore. Më tutje, aktivitetet e ndërmarra gjatë procedurës së provave në kontekstin e arsyetimit të mëtejshëm të vendimit përmes prizmit të fakteve (i)relevante, si dhe përcaktimi nëse faktet në fjalë janë të natyrës dhe cilësisë së tillë që të jenë në gjendje të korrespondojnë me atë që parashikohet në të drejtën materiale, për të prodhuar pasojë juridike. Vlerësimi, por edhe arsyetimi i argumenteve të kundërta, përkatësisht argumentet e palës që humbi procedurën, duke i vënë në relacion gjendjen faktike me të drejtën materiale, në pajtim me të cilën personi i akuzuari ndiqet penalisht, si element i rëndësishëm në arsyetimin e aktgjykimit, është pjesë përbërëse e kësaj qasjeje metodologjike, ndërsa i shoqëruar me qartësinë dhe qëndrueshmërinë e arsyetimit të dhënë, që mbështetet nga korrektësia e duhur gjuhësore dhe gramatikore, kanë rëndësi të jashtëzakonshme për cilësinë e vendimit gjyqësor.

Gjatë analizës së aktgjykimeve në rajonin e apelit në Manastir mund të përcaktohet që paragrafët hyrës të arsyetimit me cilësi solide prezantojnë në çështjen që diskutohet, dhe në mënyrë identike, u kushtojnë vëmendjen e duhur veprimeve të ndërmarra nga gjykata dhe palët në procedurë. Shikuar përmes këtij indikator, aktgjykimet në këtë rajon vlerësohen me notën më të lartë - 6. Arsyetimi i aktgjykimeve i referohet narracionit sistematik dhe kronologjik të të gjitha veprimeve të ndërmarra, por edhe përshkrimit të fakteve dhe rrethanave që japin fotografi të qartë për thelbin e lëndës.

Në përgjithësi, paragrafët individualë të arsyetimeve janë tërësi tematike dhe mundësojnë fotografi të qartë të çështjeve individuale të trajtuara në aktgjykim. Sidoqoftë, në një pjesë të aktgjykimeve ka edhe narrativa që kombinojnë disa çështje në një paragraf, i cili duket i tepërt dhe përfshin detaje të procedurës, për këtë shkak nota mesatare në përputhje me këtë indikator është 5.6 nga 6. Me qëllim të përcaktimit të duhur dhe të plotë të gjendjes faktike, është e papranueshme të përpunohen grupe provash të cilave nuk mund t'u kushtohet vëmendje e mjaftueshme për të zgjedhur faktet relevante mbi të cilat do të bazohet vendimi.

Një nga indikatorët ndoshta kryesor në metodologji, i cili është me rëndësi të jashtëzakonshme edhe për shpërndarjen e duhur të drejtësisë, por edhe për perceptimet e mëvonshme që zhvillohen prej saj, është indikator i cili nënkupton "prezantimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore relevante dhe parimeve juridike." Ai supozon që në kuadër të arsyetimit të aktgjykimit, duhet të shpjegohet norma juridike për secilën çështje, por edhe karakteristikat e veprës penale që është lëndë e ndjekjes, si dhe lloji i shkeljes së të drejtës. Një kusht shtesë për përmbushjen në nivel të lartë të cilësisë së aktgjykimeve është referimi eventual i praktikës vendase ose praktikës së Gjykatës



Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Aktgjykimet në këtë rajon të apelit, për sa i përket këtij indikator, kanë notë 4.8 nga 6. Kur bëhet fjalë për këtë indikator, vetëm 40% e aktgjykimeve të shqyrtuara në rajonin e apelit në Manastir kanë notën më të lartë, 60% e mbetur kanë cilësi të mesme. Aktgjykimet me notë më të lartë e përpunojnë në detaje veprën penale, karakteristikat dhe natyrën e saj, si dhe të mirën e mbrojtur.

Indikatori tjetër përfshin analizën e fakteve nga aspekti i lidhjes së tyre me normën juridike, përkatësisht nëse natyra e fakteve të treguara janë në kontekstin e asaj që është përcaktuar dhe që si kusht për përmbushje kërkohet në të drejtën materiale, në mënyrë që të prodhojë pasojë të caktuar juridike. Por, e përfshin edhe përpunimin dhe vlerësimin e provave, rëndësinë e tyre për rastin konkret me qëllim për të përcaktuar gjendjen faktike, ndërsa të gjithë këtë nga aspekti i vlerësimit individual të provave. Aktgjykimet e shqyrtuara përmes këtij indikator kanë notë 2.5 nga 3, për shkak se në disa prej tyre ka situata ku nuk janë përfshirë të gjitha provat e propozuara dhe të paraqitura, ku arsyetimet janë hequr për disa prova potencialisht të rëndësishme, të tilla si ekspertiza ose, është evidentuar referimi i provave në arsyetimin e aktgjyqimit që janë hequr për t'u theksuar dhe shpjeguar.

Në lidhje me çështjen e kushtimit të vëmendjes përkatëse në të gjitha rastet individuale të deklaratave dhe pretendimeve të palës që e ka humbur kontestin, diçka që do të shënohej përmes shqyrtimit dhe vlerësimit të argumenteve të kundërta, mund të konkludohet se aktgjykimet në këtë rajon të apelit i referohen notës 5,7 nga 6. Kjo notë gjen mbështetje në faktin se në një pjesë të parëndësishme të vendimeve nuk është evidentuar përpjekja minimale për arsyetim të argumentuar pse disa përgjigje të mbrojtjes nuk merren parasysh dhe kjo të mbështetet nga e drejta materiale.

Qartësia dhe qëndrueshmëria e arsyetimeve vlerësohet relativisht mirë, duke pasur parasysh që nota është 2.3 nga më e larta 3. Në aktgjykimet që u vlerësuan me notë më të ulët për sa i përket këtij indikator, u konstatua arsyetimi konfuz dhe në masë të pamjaftueshme konciz, duke treguar provat verbale, në vend të përshkrimit të tyre përmbledhës, duke kopjuar fjalët përfundimtare të palëve në procedurë, përkatësisht ritregimin e dëshmimeve të dëshmitarëve në procedurë, etj.

Korrektësia gjuhësore dhe gramatikore e tekstit të vendimeve gjyqësore nuk është në nivelin e duhur. Ato janë të kuptueshme për njerëzit laikë, përmbajnë paragrafë relativisht të shkurtër me fjali të qarta, por janë të pasakta në aspektin gramatikor ose të drejtshkrimit, ndërsa në mënyrë plotësuese është evidentuar zbatimi i dialektit lokal, për këtë shkak edhe nota është 2 nga 3.

Numri i aktgjykimeve të shkallës së dytë që u shqyrtuan në këtë rajon të apelit është 5, gjë që fillimisht nuk lejon krijimin e vlerësimit të pavarur, por edhe të besueshëm të cilësisë së vendimeve të shkallës së dytë në këtë rajon. Prandaj, vlerësimi i këtyre vendimeve, si dhe i vendimeve të tjera të gjykatave të tjera të apelit, nuk tregojnë vetvetiu

nivelin e cilësisë, por të marrë në kombinim dhe si pjesë komplementare të aktgjyqimeve të shkallës së parë, krijojnë fotografinë e cilësisë së përgjithshme në nivelin e rajonit të apelit, pavarësisht nga shkalla e veprimit.

Për qëllimet e vlerësimit të këtyre vendimeve, janë zhvilluar 11 indikatorë, nga të cilët vetëm tre përputhen, përkatësisht janë identikë me ata të parashikuara për aktgjykimet e shkallës së parë, që janë silogjizmi juridik në përmbajtje, qartësia dhe qëndrueshmëria e arsytimit dhe korrektësia gjuhësore dhe gramatikore e tekstit të vendimit. Tetë indikatorët e mbetur i referohen cilësisë së arsytimit të vendimeve të shkallës së dytë dhe të shprehur përmes udhëzimeve të qarta që Gjykata e Apelit ia jep gjykatës së shkallës së parë në kthimin eventual të vendimit për rishqyrtim; arsyet e shprehura qartë për shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë; ekzistimi i arsytimit nëse ka ndryshim në vëllimin ose lartësinë e sanksionit të shqiptuar, dhe më pak ai të arsyetohet qartë, me argumentim konkret të arsyes për vendim të tillë; ekzistimi i përgjigjes ndaj ankesave; mungesa e replikimit të gjendjes faktike identike të përcaktuar nga gjykata e shkallës së parë; në rast të ndryshimit të aktgjykimet, ai i ka të gjitha karakteristikat thelbësore të aktgjykimet, si dhe aktgjykimin e shkallës së parë; argumentimi në lidhje me ankesat dhe përkushtimi i vëmendjes për afatin e parashkrimit të lëndës.

Nota mesatare për logjikën juridike, përkatësisht silogjizmi, në këto aktgjyqime është 7.2 nga 9, që është kryesisht për shkak të faktit se vetëm në dy nga pesë aktgjykimet në përgjithësi janë shqyrtuar rregullat juridike të përcaktuara dhe të përpunuara siç duhet. Ajo që duket të jetë tipar i këtij indikator është se gjykata ka praktikë ta theksojë vetëm kualifikimin juridik pa hyrë në shpjegimin e saj, por në llogari të saj, në të gjitha vendimet shënohen konkluzionet për faktet relevante, si dhe zgjedhja dhe interpretimi i tyre.

Për sa i përket qartësisë dhe qëndrueshmërisë së aktgjyqimeve të shkallës së dytë, ato vlerësohen me notën më të lartë për këtë indikator - 3, ndërsa kategoria e korrektësisë gjuhësore dhe gramatikore të tekstit të vendimeve gjyqësore vlerësohet me 2.4 nga 3, që kryesisht i referohet përdorimit të dialektit lokal në shprehjen dhe shkrimin, si dhe prania e gabimeve teknike dhe drejtshkrimore.

Udhëzimet e qarta dhe precize për veprim të mëtejshëm të gjykatës së shkallës së parë, në kushtet e shfuqizimit dhe kthimit të vendimit, si indikator janë të pazbatueshme në të gjitha aktgjykimet, prandaj u vlerësuan vetëm në dy aktgjyqime. Pikërisht mungesa e ekzemplarit përkatës nga i cili mund të nxirret konkluzioni i besueshëm që pamundëson vlerësimin e duhur të vendimeve sipas këtij indikator. Sidoqoftë, vlen të përmendet se në këto dy raste të evidentuara kur vendimet u shfuqizuan dhe lëndët u kthyen për veprim të sërishëm në gjykatën e shkallës së parë, ato u vlerësuan me notën më të lartë të paraparë - 6, për shkak se gjykata e shkallës së dytë dha udhëzim të qartë dhe konkret se si duhet të veprojë gjykata më e ulët gjatë veprimit të sërishëm. Në këtë lidhet edhe indikator i tjetër i cili tregon nëse në kushtet e shfuqizimit ose ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, aktgjykimet e Gjykatës së Apelit i tregojnë arsyet e shprehura

qartë për të. Edhe pse këtu në numër dukshëm më të vogël, vendimet vlerësohen me notën më të lartë - 6.

Ndryshimi i vëllimit ose lartësisë së sanksionit nga gjykata më e lartë pritet të shoqërohet me arsyetime të përshtatshme dhe të arsyetuara për vendimin e tillë. Vendimet që ishin lëndë e analizës, dhe që e përmbajnë këtë indikator, janë identike me ato të mëparshmet, të vlerësuara me notën më të lartë -6. Në këto raste, gjykata dha shpjegim për vendimin e saj të ndryshëm dhe e bazoi atë në perceptimin e ndryshëm të rrethanave rënduese, veçanërisht ato që i referohen mënyrës dhe rrethanave nën të cilat është kryer vepra.

Duke marrë parasysh që gjykata e lartë është e detyruar ta arsyetojë vendimin e saj, arsytimi duhet të përmbajë dy elemente: a) vlerësimin e këshillit të gjykatës së shkallës së dytë për ankesat e bëra nga subjektet e ndryshme që kanë parashtruar ankesë; dhe b) të theksohet se cilat shkelje i vlerësoi gjykata e shkallës së dytë me detyrë zyrtare.<sup>14</sup> Si rrjedhojë, gjatë shqyrtimit të ankesave në procedurë, kjo gjykatë ka për detyrë t'u përgjigjet atyre, që në fakt ishte edhe lëndë e shqyrtimit në pajtim me metodologjinë. Lidhur me këtë indikator, Gjykata e Apelit në Manastir u vlerësua me notën 6 nga 6, me konstatimin se ankesat sipas të cilave u veprua janë përfshirë plotësisht dhe për to ka arsyetim përkatës.

Duke pasur parasysh që zgjedhja e aktgjykimeve nga ky rajon i apelit ka vetëm dy aktgjykime për të cilat është i zbatueshëm indikator i lidhje me ndryshimin e tij, dhe në të dyja rastet bëhet fjalë për ndryshimin e aktgjykimit vetëm për sa i përket lartësisë ose zgjedhjes së sanksionit, vlerësimi i këtij indikator nuk mund të merret plotësisht si relevant. Kjo është veçanërisht për shkak të faktit se gjykata nuk iu qas konstatimit të gjendjes faktike, analizës së hollësishme të provave të paraqitura tashmë që e krijojnë gjendjen faktike, si dhe arsytimit të së drejtës materiale në mënyrë identike, si dhe për çdo vendim gjyqësor të shkallës së parë, sepse hyri në analizë vetëm në ato prova që janë relevante me llojin ose për lartësinë e sanksionit.

Indikator i fundit i metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së aktgjykimeve të shkallës së dytë i referohet asaj nëse gjykata dhe në çfarë mase i kushton vëmendje afatit të parashikuar për parashkrimin absolut të ndjekjes penale për veprën penale konkrete, lëndë e diskutimit. Vlerësimi i kësaj kategorie supozon operacion kompleks nëse merret parasysh se përveç komponentit themelor - rrjedhës së kohës, është e domosdoshme të llogaritet edhe kompleksiteti i lëndës në aspektin e materialit të provave, sigurimin e tij, propozimin dhe realizimin, si dhe si seriozitetin e veprës penale me të cilën ngarkohet. Në bazë të kësaj, vlerësimi modest i të gjitha këtyre parametrevë që do të ndikonin në kohëzgjatjen e procedurës i referohet notës 4.4 nga 6.

Duke pasur parasysh vlerësimin e cilësisë përmes të gjithë indikatorëve të vendosur, indeksi i cilësisë në këtë rajon të apelit përcaktohet në 4.6.

14 Коментар на ЗКП.

## KONKLUZIONI DHE REKOMANDIMET

Struktura e drejtë e aktgjyqimeve, si dhe harmonizimi i plotë me standardet e parashikuara për atë se çfarë duhet të jetë struktura e aktgjykimit, është ajo që mund të përcaktohet pa përjashtim gjatë evalvimit të aktgjyqimeve nga rajoni i apelit në Manastir. Ato mundësojnë harmonizim logjik dhe lidhshmëri të shqiptimit dhe arsyetimit, si dhe kompaktësinë dhe jokundërshtimin e tyre, me çka në asnjë rast nuk devijojnë nga koncepti i koherencës.

Cilësia e pjesëve hyrëse që i referohen çështjes konkrete lëndë e diskutimit, si dhe vëmendja e duhur që i kushtohet veprimeve të palëve në procedurë tregojnë për narracionin sistematik dhe kronologjik të të gjitha veprimeve të ndërmarra, por edhe përshkrimin e fakteve dhe rrethanave që japin fotografi të qartë për esencën e lëndës sipas së cilave veprohet. Megjithëse në një pjesë ndoshta të parëndësishme, është përcaktuar të përpunohen grupe provash që nuk mund t'u kushtohet vëmendje e mjaftueshme që të mund të zgjidhen faktet relevante mbi të cilat do të bazohet vendimi, gjë që është e papranueshme nga aspekti i argumentimit të provave. Por, edhe mbivlerësimi i tërësive individuale - paragrafëve që duhej të përpunojnë segmente të ndryshme të gjendjes faktike ose provave në lidhje me të. Kjo nuk është përshtypja e përgjithshme lidhur me të gjitha aktgjykimet e analizuara, por perceptimi individual i punës së gjykatësve të caktuar është, në çdo rast, me rëndësi të veçantë dhe mund të kontribuojë në tejkalimin e këtyre praktikave dhe braktisjen e tyre graduale.

Ajo që është lokalizuar si më problematike në aktgjykimet e shqyrtuara është moskushtimi i vëmendjes së mjaftueshme normave juridike për secilën çështje, por edhe karakteristikat e veprës penale që është lëndë e ndjekjes, si dhe lloji i shkeljes së të drejtës. Gjashtëdhjetë për qind e aktgjyqimeve në këtë rajon vlerësohen me cilësi të mesme kur bëhet fjalë për shpjegimin e normave juridike, veprën e parashikuar penale, shtjellimin teorik të thelbit të veprës, karakteristikat e saj, por edhe lëndën e mbrojtjes. Në nivelin e lartë të cilësisë së aktgjyqimeve sigurisht që do të kontribuonte edhe referimi eventual i praktikës vendase ose praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Si rrjedhojë, me rëndësi të veçantë do të ishte të arrihet shkalla e barazisë solide në veprimet e gjykatësve individuale që argumentojnë në detaje dhe arsyetojnë normat hetimore, por edhe normat materiale, ndërsa në mbështetje të konfirmimit ose refuzimit të tezës së prokurorisë, me ata që nuk i kushtojnë vëmendje të veçantë kësaj.

Vendimet e Gjykatës së Apelit në aspektin e logjikës juridike i referohen praktikës në të cilën gjykata e thekson vetëm kualifikimin juridik, pa hyrë në shpjegimin e saj, por në llogari të saj, në të gjitha vendimet shënohen konkluzionet në lidhje me faktet relevante, si dhe zgjedhja e tyre dhe interpretimi i tyre.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që një aktgjykim t'i përfshijë të gjitha provat e propozuara dhe të paraqitura, si dhe t'i arsyetojë siç duhet. Në kuadër të këtij rajoni të apelit, u konstatua se në një numër të vogël, megjithatë, me rëndësi të veçantë, gjykatat

nuk i përmbushnin plotësisht kriteret në lidhje me këto parametra, prandaj përpunimi dhe vlerësimi i provave, rëndësia e tyre për rastin konkret në mënyrë që të përcaktohet gjendja faktike, dhe e gjithë kjo nga aspekti i vlerësimit individual të provave, është në nivel më të ulët.

Është e domosdoshme të shmanget praktika relativisht e parëndësishme e mungesës së arsytimit të argumentuara kur bëhet fjalë për adresimin e pretendimeve të mbrojtjes. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që gjykatat t'i kushtojnë vëmendjen e duhur mbështetjes së qëndrimeve të tyre me të drejtën materiale, veçanërisht kur bëhet fjalë për refuzimin e pretendimeve nga pala që ka humbur kontestin. Si dhe praktika e pasqyrimin të deklaratave identike të dëshmitarëve në procedurë, përkatësisht kopjimin e tyre nga procesverbalet, të cilat krijojnë fotografinë e paragrafëve jo aq të qartë dhe konciz në vendimet. Qartësia dhe konciziteti i vlerësuar dobët i disa prej aktgjykimeve të gjykatave themelore kompensohet nga vlerësimi i lartë i këtyre karakteristikave kur bëhet fjalë për vendimet e Gjykatës së Apelit.

Ajo që vihet re veçanërisht në vendimet që vijnë nga ky rajon i apelit është fakti se ato nuk kanë nivel të kënaqshëm të korrektësisë gjuhësore dhe gramatikore. Në përgatitjen e tyre me shkrim, përdoret dialekti lokal, identik me rajonin e të folurit të qytetit të Manastirit, por evidentohen edhe lëshime të caktuara në zbatimin e drejtshkrimit maqedonas.

Veprimi i gjykatës më të lartë sipas vendimeve, dhe posaçërisht në kushtet e ndryshimit të vëllimit ose llojit të sanksionit, udhëzimet për veprimin e sërishëm të gjykatës më të ulët ose në kushtet e vendimmarrjes së saj meritore, është në përputhje të plotë me dispozitat e parashikuara në Ligjin për procedurë penale. E vetmja vërejtje që mund të bëhet është të konstatohet vëmendja e pamjaftueshme që kjo gjykatë i kushton rrjedhës së kohës dhe në kontekstin e parimit të parashkrimit absolut të ndjekjes penale. Si rrjedhojë, si rekomandim, duhet theksuar se funksionimi më efikas i gjykatës së shkallës së dytë është i domosdoshëm, veçanërisht në lidhje me procedurat që parashikojnë vepra penale për të cilat gjasa të ndodhë parashkrimi është më e lartë.

### 1.3.2 Cilësia e vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit në Gostivar

Indikatorët hyrës të parashikuar në metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore, të cilat parashikojnë indikatorë në lidhje me strukturën dhe koherencën e vendimit gjyqësor, në kuadër të evalvimit të aktgjykimeve në këtë rajon të apelit, si edhe më parë, u analizuan përmes prizmit të strukturimit të drejtë të vendimeve, përmbajtjes së tyre në aspektin e pjesëve të nevojshme, qartësisë dhe koncizitetit të shqiptimeve, por edhe harmonizimit të tyre logjik me arsytimin, përkatësisht mungesën e kundërshtimit të ndërsjellë.

Nga aktgjykimet e analizuara në këtë rajon të apelit, përkatësisht vendimet e gjykatës themelore, vihet në konstatimin se në më pak se 40% të aktgjykimeve, në këtë rast në tre, duke pasur parasysh se numri është i vogël dhe nuk është i mjaftueshëm të përcaktohet si ekzemplar përfaqësues, vërehet qartësia dhe konciziteti i pamjaftueshëm të ta. Ky konkluzion nuk del nga vlerësimi drastikisht më i ulët i këtyre indikatorëve, por vë në dukje cilësinë e mesme të përmbushjes së një pjese të këtyre indikatorëve dhe i referohet notës prej 2.9 nga 3 për strukturën e vendimit gjyqësor, përkatësisht strukturimit të saj nga të gjitha pjesët e nevojshme, dhe 5,25 nga 6 për sa i përket qartësisë, përkatësisht koncizitetit të vendimit.

Logjika juridike si pjesë thelbësore e një vendimi gjyqësor u shqyrtua duke përcaktuar nëse subsumcioni është kryer siç duhet ose nëse gjendja faktike konkrete e përcaktuar në aktgjykimet, duke zbatuar normat juridike të zbatueshme për rastin konkret, prodhonte veprime juridike. Shqiptimi i aktgjykimit ka ndikim thelbësor në përmbajtjen e arsytimit, që domosdoshmërisht duhet të dalë dhe të bazohet në të, por në mënyrë plotësuese është e rëndësishme që ajo të jetë në përputhje me përmbajtjen e shqiptimit, përkatësisht mos të jetë në kundërshtim të ndërsjellë. Supozohet se arsyetimet e aktgjykimeve janë koherente dhe në harmonizim logjik të shoqëruara me argumentimin e zgjeruar të dispozitivit të aktgjykimit, më tej, të procedurës së miratimit të vendimit, si dhe të rregullave të gjykimet gjyqësor në rastin konkret.

Megjithëse në përputhje me metodologjinë dhe pikëzimin e indikatorëve për këtë çështje, nota 9 është parashikuar si më e larta, në rastin konkret u përcaktua nota 5.1. Kjo është kryesisht për shkak të mungesës së shpjegimit përkatës të rregullave juridike, në një pjesë të vlerësimit joadekuat të provave të propozuara dhe të paraqitura gjatë procedurës, si dhe konkluzioneve të nxjerra nga faktet relevante, të cilat në vend që të pasqyrojnë tërësinë individuale, ato bazohen në deklarata të kopjuara të palëve.

Vlerësimi i aktgjykimeve nga ky aspekt përfshin përshkrimin në lidhje me pohimet faktike të palëve në procedurën për gjendjet faktike konkrete në të cilat kanë ndodhur situatat juridike-penale, procesi i propozimit dhe realizimit, por edhe veçimi i fakteve të domosdoshme nga faktet e diskutueshme, si dhe vlerësimi i provave gjatë procedurës.

Ratio decidendi i shqyrtuar përmes cilësisë së arsytimit të vendimit gjyqësor e përfshin historikun e çështjes që është lëndë e përcaktimit dhe sipas së cilës veprohet, prezantimi i saj, prezantimi i mëtejshëm dhe zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore përkatëse dhe parimeve juridike, përcaktimi i gjendjes faktike dhe procedurës së provave, vlerësimi i argumenteve të kundërta, qartësia dhe qëndrueshmëria e arsytimit, por edhe korrektesia gjuhësore dhe gramatikore e tekstit të vendimit gjyqësor.

Shpjegimi i historikut të çështjes, më saktë nëse me paragrafët hyrës të vendimit, përkatësisht arsytimi i tij, gjykata fut në këtë çështje, si dhe kronologjinë e veprimeve të ndërmarra nga gjykata në lidhje me parashitjet e zbatuara dhe të shqyrtuara dhe

perspektiva e diskutimeve vlerësohet me notën më të lartë - 6. Kjo pasi gjykata gjatë veprimit i kushtoi vëmendjen e duhur përmbushjes së kriterëve të këtij indikatorit.

Lidhur me indikatorin që përcakton përshkrimin e duhur të fakteve dhe rrethanave që duhet të shpjegojnë thelbin e lëndës, si dhe faktin nëse secila çështje është në paragraf të veçantë me shpjegimin e saj bindës, por edhe nëse ka referimin e fakteve (i)relevante, ky rajon i apelit vlerësohet me 5.1 nga 6. Ulja e vlerësimit të këtij indikatorit është për shkak të përshtypjes së krijuar nga paragrafët e tepërt në aktgjykime, të cilat shpesh përfshijnë nga disa çështje, ndërsa krijohen si tërësi në vendim vetëm për shkak se dalin nga deklaratat e një dëshmitari, pavarësisht nga fakti që ai me deklaratën e tij trajton më shumë çështje.

Indikatorit i vlerësuar më dobët në këtë rajon të apelit, ndërsa në përputhje me metodologjinë për përcaktimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore, është indikatorit në lidhje me shpjegimin e normës juridike për secilën çështje, karakteristikave të veprës penale, llojit të shkeljes, si dhe referimit eventual të praktikës vendase, përkatësisht praktikës së GJEDNJ-së. Në vendimin e vlerësuar më dobët, u konstatua mungesa e normës së arsyetuar juridike, karakteristikat e veprës penale, natyra e tij, lloji i shkeljes dhe e mira e mbrojtur, si dhe praktika gjyqësore. Më shpesh, në aktgjykimet ka përshkrim të veprimeve që konstatohet se janë përmbushja e thelbit të veprës penale ose, ka edhe formulime të tilla si: "Në bazë të fakteve të përcaktuara në këtë mënyrë, gjykata konstaton se në veprimet e të akuzuarit N.N. përmbahen tiparet ligjore të veprës penale MASHTRIM nga neni 247 paragrafi 1 të Kodit Penal, për të cilën e shpall fajtor dhe e dënoi me burgim efektiv si në dispozitivin e këtij aktgjykimi", ose "Në gjendjen faktike të përcaktuar në këtë mënyrë, gjykata ka përcaktuar me siguri se në veprimet e të akuzuarit përmbahen elementet thelbësore të veprës penale Vjedhja e energjisë elektrike, energjisë termike ose gazit natyror nga neni 235-a paragrafi 1 të Kodit Penal". Kjo aspak nuk e përmbush standardin përkatës për përshkrimin e veprës, karakteristikat e saj në pajtim me teorinë, zërthimin e elementeve themelore dhe thelbin e saj, llojin e së mirës së mbrojtur, si dhe shkeljen. Vlerësimi i përgjithshëm i këtij indikatorit përcaktohet me 0.6 nga nota më e lartë e parashikuar - 6.

Kur vlerësohet rëndësia e provave, si dhe ekzistimi i arsytimit të hollësishëm pse disa trajtohen si të parëndësishëm, por edhe vlerësimi dhe analiza e secilës provë veç e veç, dhe jo së bashku, ky rajon i apelit ka notë 2.7 nga 3. Mosarritja e notës më të lartë për këtë çështje është për shkak të mungesës së arsytimit në disa prej aktgjykimeve sepse disa nga provat që janë marrë parasysht merren si relevante, në llogari të kësaj, është evidentuar vetëm kopjimi i tyre pa arsytimin e tyre.

Indikatorit në lidhje me shqyrtimin dhe vlerësimin e argumenteve të kundërta, më saktë argumentet e palës që ka humbur kontestin, nuk mund të ishte lëndë e vlerësimit për shkak që pothuajse të gjitha aktgjykimet e zgjedhura rastësisht që ishin në dispozicion publikisht ishin aktgjykime për lëndët në të cilat personi i akuzuari është i gjykuar në mungesë, kështu që ai nuk është në gjendje të propozojë prova ose i është caktuar mbrojtës me detyrë zyrtare i cili nuk ka propozuar prova.

Qartësia dhe qëndrueshmëria e arsytimit dhe shkarkimi i tij i detajeve të panevojshme, procesverbalet e kopjuara, si dhe deklaratat e thëna të dëshmitarëve, në aktgjykimet e vlerësuara vlerësohet me 2.2 nga 3 për shkak të natyrës së thënë të provave, veçanërisht ato të natyrës verbale, mungesës së arsytimit të sublimuar të provave, si dhe faktit që ato janë kopjuar kryesisht nga procesverbalet gjatë procedurës. Ndërsa, korrektësia gjuhësore dhe gramatikore e tekstit vlerësohet me 2 nga 3, për shkak të mungesës së fjalive të sakta gramatikore dhe të shtypit, si dhe pranisë së gabimeve drejtshkrimore.

Aktgjykimet e shkallës së dytë në këtë rajon të apelit u shqyrtuan në mënyrë identike përmes prizmit të 11 indikatorëve të paraparë në metodologji, të cilët përfshijnë si silogjizmin juridik gjatë subsumcionit, ashtu edhe strukturën përkatëse të arsytimit.

Analiza e tyre në aspektin e logjikës juridike, përkatësisht silogjizmit, i referohet notës 7.5 nga 9. Kjo kryesisht për faktin se në gjysmën e aktgjykimeve të shqyrtuara nuk janë përcaktuar dhe as përpunuar rregullat juridike. Është shënuar vetëm theksimi eventual i kualifikimit juridik, por për sa i përket pjesës tjetër të parametrave të domosdoshme që përbëjnë këtë indikator, janë evidentuar konkluzionet në lidhje me faktet relevante, si dhe zgjedhja dhe interpretimi i tyre.

Për sa i përket qartësisë dhe qëndrueshmërisë së aktgjykimeve të shkallës së dytë, ato vlerësohen me notën më të lartë për këtë indikator - 3, ndërsa kategoria e korrektësisë gjuhësore dhe gramatikore të tekstit të vendimeve gjyqësore vlerësohet me 2.5 nga 3, për shkak të faktit që në to evidentohen gabimet teknike dhe drejtshkrimore.

Indikatorin në lidhje me ofrimin e udhëzimeve të sakta dhe të qarta për gjykatën më të lartë në gjykatën më të ulët, ndërsa në rast të shfuqizimit dhe kthimit të aktgjykimit të shkallës së parë të gjykatës themelore për vendimmarrje të sërishme, u vlerësua në vetëm një aktgjykim. Si rrjedhojë, vlerësimi i këtij indikator, megjithëse i vlerësuar me vlerësimin më të lartë, nuk mund të merret si relevant.

Indikatorin në lidhje me vlerësimin e udhëzimeve të gjykatës më të lartë gjatë shfuqizimit ose ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, si dhe i mëparshëm, vlerësohet vetëm në një aktgjykim dhe në mënyrë identike edhe në këtë rast, ai ka notë të lartë.

Ndryshimi në vëllimin ose lartësinë e sanksionit në aktgjykimet e vlerësuara nuk ishte shënuar, prandaj edhe ky indikator nuk vlerësohet për këtë rajon të apelit.

Vlerësimi i këshillit të gjykatës së shkallës së dytë të ankesave të paraqitura, si dhe përcaktimi i shkeljeve që gjykata e shkallës së dytë eventualisht do t'i vërente dhe vlerësonte me detyrë zyrtare, por edhe shqyrtimi veçmas i ankesave në procedurë, janë obligim ligjor për çdo gjykatës që vepron në shkallën e dytë. Në bazë të kësaj, aktgjykimet e Gjykatës së Apelit në Gostivar u vlerësuan përmes indikatorëve përkatës dhe ata kanë notën më të lartë të përcaktuar në përputhje me këtë indikator.



Duke i pasur parasysh kategoritë e kohës, kompleksitetin e lëndës, si në aspektin e materialit të provave, ashtu edhe në aspektin e realizimit të saj, por edhe seriozitetin e veprës penale me të cilën akuzohet dhe numrin eventual të personave të akuzuar në procedurë, indikatori i fundit i metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së aktgjykimeve të shkallës së dytë, që i referohet faktit nëse dhe në çfarë shkalle gjykata i kushton vëmendje afatit të parashikuar për parashkrimin absolut të ndjekjes penale për veprën penale konkrete u vlerësua me 5.5 nga 6.

Duke pasur parasysh vlerësimin e cilësisë përmes të gjithë indikatorëve të vendosur, indeksi i cilësisë në këtë rajon të apelit përcaktohet në 4.2.

## KONKLUZIONI DHE REKOMANDIMET

Qartësia dhe konciziteti i pamjaftueshëm, por edhe strukturimi i aktgjykimeve është konstatuar në një pjesë të vendimeve të analizuara në nivelin e rajonit të apelit në Gostivar, që vijnë nga shkalla e parë. Vendimet e shkallës së dytë janë kryesisht të qarta dhe të qëndrueshme. Prandaj, gjykatat themelore në këtë rajon duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje koherencës së vendimeve, t'i bëjnë më të kuptueshme dhe të jenë në harmonizim logjik me arsyetimin. Në një pjesë të vendimeve, është konstatuar mungesa e arsyetimit të çështjeve juridike, si nga gjykatat themelore, ashtu edhe nga Gjykata e Apelit.

Është evidentuar praktika pozitive e shpjegimit adekuat të historikut të çështjes, si dhe kronologjia e veprimeve të ndërmarra nga gjykata dhe palët në procedurë. Sidoqoftë, gjykimeve në këtë rajon u mungon shpjegimi përkatës i rregullave juridike, si dhe përshkrimi joadekuat për vlerësimin e provave të propozuara dhe të paraqitura gjatë procedurës, me ç'rast në vend që të pasqyrojnë tërësinë individuale, ato bazohen në deklaratat e kopjuara të palëve.

Vëllimi i përmbajtjes së paragrafëve në aktgjykimet shihet përmes rrethanave që tregojnë në faktin se gjykata ka praktikë për të trajtuar më shumë çështje në një tërësi, vetëm për shkak që dalin nga deklaratat e një dëshmitari. Sidoqoftë, meqenëse gjykata duhet të japë argumentim të individualizuar për secilën çështje dhe provë, është e domosdoshme t'i qaset ndryshimit të kësaj praktike.

Shpjegimi i normës juridike për secilën çështje, si dhe karakteristikat e veprës penale, lloji i shkeljes, por edhe referimi eventual i praktikës vendase, përkatësisht praktika e GJEDNJ-së, është diçka në pajtim me të cilën ky rajon i apelit vlerësohet më së paku krahasuar me të tjerat. Prandaj, gjykatat e këtij rajoni të apelit është e domosdoshme të njoftohen me praktikën e veprimit në rajonet e tjera të apelit, dhe veçanërisht duke pasur parasysh që qasja e tillë është në nivelin e standardit të konstatuar të veprimit.

Mungesa e arsytetimeve në disa prej aktgjykimeve se pse disa nga provat nuk u argumentuan, as nuk u dha arsytimi se pse nuk u morën si të rëndësishme, dhe në llogari të kësaj ato vetëm u kopjuan pa arsytimin e tyre, paraqet devijim nga parimi në përputhje me të cilën gjykata është e detyruar të vlerësojë me ndërgjegje secilën provë veçmas dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë konkluzion nëse ndonjë fakt do të konsiderohet i dëshmuar apo jo dhe nëse vendimi do të bazohet në të. Mungesa e arsytimit të sublimuar të provave u konstatua gjithashtu, duke pasur parasysh që në masë të madhe ato ishin kopjuar nga procesverbalet gjatë procedurës.

Është e nevojshme që gjykata t'i kushtojë vëmendje edhe korrekhtësisë së domosdoshme gjuhësore dhe gramatikore të tekstit, për shkak të mungesës së fjalive të sakta gramatikisht, në të cilat evidentohen edhe gabimet e shtypit dhe drejtshkrimore.

Veprimi i gjykatës së shkallës së dytë në përputhje me kompetencat e tyre, ndërsa në drejtim të udhëzimeve të sakta dhe të qarta nga gjykata më e lartë në gjykatën më të ulët, në rast të shfuqizimit dhe kthimit ose në rast të ndryshimit eventual të aktgjykimit të shkallës së parë vlerësohen shumë në masë të madhe edhe në përputhje me dispozitat e parapara të LPP-së. Identike me këtë, veprimi i gjykatës së shkallës së dytë për ankesën, gjatë vlerësimit të ankesave dhe të gjithë procedurës ankimore është në përputhje me kriteret e përcaktuara, si dhe veprimi i tij në kohë, duke i marrë parasysh mundësitë për parashkrimin e ndjekjes penale.

### 1.3.3 Cilësia e vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit në Shkup

Grupi i parë i indikatorëve që parashikohen në metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore ofron indikatorë në lidhje me strukturën dhe koherencën e vendimit gjyqësor. Në kuadër të evalvimit të aktgjykimeve në përputhje me indikatorët e vendosur, u analizua nëse vendimet i përmbajnë të gjitha pjesët e nevojshme dhe nëse janë të strukturuar si duhet, nëse shqiptimet e vendimeve janë të qarta koncize, por edhe nëse janë në harmonizim logjik me arsytimin, më saktë nuk janë në kundërshtim të ndërsjellë.

Ajo që u përcaktua dhe u referohet pothuajse pa përjashtim të gjitha aktgjykimeve të zgjedhura për vlerësim në kuadër të rajonit të apelit në Shkup, përkatësisht Gjykatës Themelore Penale në Shkup, është fakti që gjykata në hartimin e vendimeve, dhe përmes prizmit të këtyre indikatorëve, nuk heq dorë nga standardet e parashikuara. Pra, vetëm në një rast u konstatua shqiptimi i tepruar, i cili është rezultat i përshkrimit identik të dispozitivit të akuzës, kështu që shqiptimi i aktgjykimit nuk heq dorë nga standardi i qartësisë, por nga konciziteti. Në rastin konkret, padyshim duke u nisur nga identiteti i domosdoshëm objektiv midis aktgjykimit dhe akuzës, gjykata, duke ndjekur përshkrimin e gjerë të veprës dhe rrethanat e aktakuzës, kontribuoi në koncizitetin e pamjaftueshëm të aktgjykimit në pjesën e dispozitivit të tij.

Në asnjë prej aktgjykimeve që u shqyrtuan nuk u konstatua mungesa e koherencës, përkatësisht gjendjes në të cilën shqiptimi i aktgjykimit nuk është në harmonizim logjik me arsyetimin, më saktë ekzistimi i kundërshtimit të tyre të ndërsjellë.

Tërësia e radhës e indikatorëve i referohet logjikës juridike. Më saktë, lënda e përcaktimit është nëse subsumcioni është kryer siç duhet ose nëse gjendja faktike konkrete është konstatuar në aktgjykimet, duke zbatuar normat juridike të zbatueshme për rastin konkret, prodhon veprime juridike. Në këtë rast, shqiptimi i aktgjykimit do të ndikonte në përmbajtjen e arsyetimit, që domosdoshmërisht duhet të dalë dhe të bazohet në shqiptimin, por në mënyrë identike është po aq e rëndësishme që ajo të jetë në përputhje me përmbajtjen e shqiptimit, më saktë mos të jetë në kundërshtim të ndërsjellë. Arsyetimet e aktgjykimeve duhet të jenë koherente dhe në harmonizim logjik, përkatësisht argumentim të gjerë të dispozitivit të aktgjykimit, të procedurës së miratimit të vendimit, si dhe të rregullave të gjykimit gjyqësor në rastin konkret.

Gjatë vlerësimit të aktgjykimeve nga ky aspekt u mor parasysh përshkrimi në lidhje me pohimet faktike të palëve në procedurën për gjendjet faktike konkrete në të cilat kanë ndodhur situatat juridike-penale, procesi i propozimit dhe realizimit, por edhe veçimi i fakteve të domosdoshme nga faktet e diskutueshme, si dhe vlerësimi i provave gjatë procedurës.

Nga analiza e aktgjykimeve në rajonin e apelit në Shkup mund të përcaktohet se në një pjesë të konsiderueshme të tyre ka mungesë të arsyetimit adekuat të rregullave juridike, në mënyrë që së bashku me gjendjen faktike të përcaktohet shqiptimi i aktgjykimit. Në rastin konkret, lidhja midis premisë së vogël dhe asaj të madhe, më saktë procesit të vlerësimit të provave nga i cili del premisa e vogël - kualifikimi juridik i fakteve ose përcaktimi i gjendjes faktike, me zgjedhjen e normave juridike, lidhja e tyre, përcaktimi i përmbajtjes dhe interpretimit ose premisa e madhe, siç përcaktohet në metodologji, nuk mund të identifikohet plotësisht. Në bazë të kësaj, rajoni i apelit në Shkup në përputhje me këtë indikator ka notë mesatare 6.8 nga gjithsej 9.

Grupi i fundit i indikatorëve, i cili është më i vëllimshëm në metodologjinë e vlerësimit të cilësisë, i referohet cilësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, përkatësisht ratio decidendi. Kjo pjesë përfshin shpjegimin e historikut të çështjes që është lëndë e përcaktimit, paraqitjen e saj, si dhe prezantimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore relevante dhe parimeve juridike, përcaktimin e gjendjes faktike dhe procedurën e provave, shqyrtimin dhe vlerësimin e argumenteve të kundërta, përkatësisht argumentet e palës që humbi procedurën, qartësinë dhe qëndrueshmërinë e arsyetimit, si dhe korrektësinë gjuhësore dhe gramatikore të tekstit të vendimit gjyqësor.

Në këtë pjesë të qasjes metodologjike për analizë, aktgjykimet e shqyrtuara të këtij rajoni të apelit pa përjashtim tregojnë për cilësinë solide 4 nga 7 indikatorë. Paragrafët hyrës të arsyetimit padiskutueshëm dhe me cilësi solide prezantojnë në çështjen që diskutohet dhe në mënyrë identike u kushtojnë vëmendjen e duhur veprimeve të

ndërmarra nga gjykata dhe palët në procedurë. Prandaj, aktgjykimet nga rajoni i apelit në Shkup vlerësohen me notën më të lartë - 6. Në aktgjykimet evidentohet harmonizimi logjik dhe sistematik i të gjitha veprimeve, si dhe përshkrimi i fakteve dhe rrethanave që shpjegojnë thelbin e lëndës. Tërësitë tematike janë të përfshira në paragrafë të veçantë, duke dhënë pamje të qartë për të gjitha çështjet individuale të trajtuara në aktgjykim. Në procesin e përpunimit të provave, vëmendje i kushtohet të zgjidhen të rëndësishmet, për të kontribuar në mënyrë të drejtë dhe në tërësi në konstatimin e gjendjes faktike. Ata i nënshtrohen arsytimit përkatës, veçanërisht ato që konsiderohen të parëndësishme dhe që nuk ishin të rëndësishme dhe do të ndikonin në vendimmarrje ndryshe. Vlerësimi dhe analiza e provave kryhet në mënyrë të tillë që secila provë të shqyrtohet dhe vlerësohet veçmas, pa u evidentuar grupimi i provave dhe arsytimi i tyre i përgjithshëm i përbashkët. Duke qenë se për sa i përket këtij indikator, përmbushja e kriterëve është në nivel të lartë, nota për të është 6 nga 6.

Lidhur me çështjen e kushtimit të vëmendjes përkatëse në të gjitha rastet individuale të deklaratave dhe pretendimeve të palës që ka humbur kontestin, diçka që do të vërehej përmes shqyrtimit dhe vlerësimit të argumenteve të kundërta, mund të konstatohet se aktgjykimet në këtë rajon të apelit i referohen notës 3,8 nga 6. Kjo kryesisht për faktin se në një pjesë të aktgjykimeve të vlerësuara më ulët në kontekstin e këtij indikator, nga gjykatat evidentuan se janë marrë parasysht edhe pretendimet e palës që ka humbur kontestin. Megjithatë, nuk është theksuar kurrfarë arsytimi thelbësor se pse nuk janë. Si praktikë, vihet re fakti se në rastet kur si paditës i autorizuar paraqitet prokuroria publike në procedurë, ndërsa në rastet kur është miratuar aktgjykimi lirues ose aktgjykimi refuzues, shënohet argumentimi në të cilën si mbështetje është arsyetuar edhe e drejta materiale, për atë pse nuk janë marrë parasysht pretendimet e prokurorisë. Në rastet e tjera, ku gjenden aktgjykime dënuese, e drejta materiale nuk theksohet si mbështetje për të, sepse argumentet e mbrojtjes nuk u morën parasysht.

Cilësi më shqetësuese, në përputhje me indikatorët e vendosur, aktgjykimet treguan në pjesën e "prezantimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore dhe nënligjore relevante dhe parimeve juridike". Ky indikator supozon që në kuadër të arsytimit të aktgjykimet, duhet të shpjegohet norma juridike për secilën çështje, por edhe karakteristikat e veprës penale që është lëndë e ndjekjes, si dhe lloji i shkeljes së të drejtës. Një kusht shtesë për përmbushjen në nivel të lartë të cilësisë së aktgjykimeve është referimi eventual i praktikës vendase ose praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Aktgjykimet nga rajoni i apelit në Shkup në lidhje me këtë indikator kanë notë 3 nga 6. Vetëm tre nga 15 aktgjykimet e shqyrtuara të gjykatës themelore në lidhje me këtë indikator kanë notën më të lartë, gjashtë janë me cilësi të mesme, dy janë minimale, ndërsa katër i përmbushin standardet minimale të cilësisë. Aktgjykimet me notën më të lartë në detaje e trajtojnë veprën penale, karakteristikat dhe esencën e saj, si dhe të mirën e mbrojtur. Ata që nuk përmbushin standardin minimal të cilësisë ose kanë notë të ulët që i referohet standardit minimal tregojnë vetëm për cilën vepër penale bëhet fjalë dhe se veprimet e të akuzuarit përmbushin thelbin e saj, pa hyrë ose lidhur veprimet

e kundërligjshme konkrete të ndërmarra nga i akuzuari, dhe përmbahen në thelbin e veprës penale. Faza më e zakonshme e përdorur në këtë kontekst në aktgjykime është "Në bazë të gjendjes faktike të përcaktuar kështu, gjykata konstatoi se në veprimet e të akuzuarit N.N., përmbahen të gjitha elementet thelbësore të veprës penale XX nga neni XXX të Kodit Penal, për këtë shkak ai u shpall fajtor dhe u dënua në përputhje me Ligjin".

Indikatori që i referohet qartësisë dhe qëndrueshmërisë së arsyetimit është vlerësuar mjaft mirë, me përjashtim të dy aktgjykimeve në të cilat deklaratat e dëshmitarëve, si dhe palëve në procedurë (fjalët përfundimtare) janë kopjuar plotësisht dhe përmbajtja e tyre duket se është identike me atë të procesverbaleve, për shkak se ajo nuk është shpjeguar dhe as nuk janë nxjerrë qëllimet kryesore, as nuk janë thënë ose parafrazuar në shkallë përkatëse, të pranueshme për një arsyetim. Pikërisht këto dy aktgjykime kontribuuan në uljen e notës në lidhje me këtë indikator nga nota më e lartë 3 në 2.6.

Korrektesia gjuhësore dhe gramatikore e tekstit të vendimeve gjyqësore është në nivel jashtëzakonisht të lartë, ato janë të kuptueshme për personat laikë, përmbajnë paragrafë relativisht të shkurtër, me fjali të qarta. Ato janë gramatikisht të sakta, me gjuhë të përdorur letrare dhe pa gabime teknike dhe drejtshkrimore, prandaj vlerësohen me notën më të lartë për këtë indikator - 3.

Gjatë shqyrtimit të aktgjykimeve të shkallës së dytë, u morën parasysh 11 indikatorë të veçantë, nga të cilët vetëm tre përputhen, përkatësisht janë identikë me ata të parashikuar për aktgjykimet e shkallës së parë, që janë silogjizmi juridik gjatë subsumcionit, qartësisë dhe qëndrueshmërisë së arsyetimit dhe korrektësisë gjuhësore dhe gramatikore të tekstit të vendimit. Tetë indikatorët e mbetur i referohen cilësisë së arsyetimit të vendimeve të shkallës së dytë dhe të shprehur përmes udhëzimeve të qarta që Gjykata e Apelit ia jep gjykatës së shkallës së parë në kthimin eventual të vendimit për rishqyrtim; arsytet e shprehura qartë për shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë; ekzistimi i arsyetimit nëse ka ndryshim në vëllimin ose lartësinë e sanksionit të shqiptuar, dhe më pak ai të arsyetohet qartë, me argumentim konkret të arsyes për vendim të tillë; ekzistimi i përgjigjes ndaj ankesave; mungesa e replikimit të gjendjes faktike identike të përcaktuar nga gjykata e shkallës së parë; në rast të ndryshimit të aktgjykimit, ai i ka të gjitha karakteristikat thelbësore të aktgjykimit, si dhe aktgjykimin e shkallës së parë; argumentimi në lidhje me ankesat dhe përkushtimi i vëmendjes për afatin e parashkrimit të lëndës.

Kur analizohen aktgjykimet nga aspekti i logjikës juridike, përkatësisht silogjizmi, aktgjykimet e bëra nga Gjykata e Apelit në Shkup kanë notë 6 nga 9. Kjo kryesisht për faktin se në asnjë nga të shqyrtuarat nuk janë përcaktuar, as hartuar rregullat juridike. Evidentohet vetëm theksimi eventual i kualifikimit juridik, por në llogari të kësaj, konkluzionet rreth fakteve relevante janë shënuar në të gjitha, si dhe zgjedhja e tyre dhe interpretimi i tyre.

Për sa i përket qartësisë dhe qëndrueshmërisë së aktgjyqimeve të shkallës së dytë, ato vlerësohen me notën më të lartë për këtë indikator - 3, ndërsa kategoria e korrekhtësisë gjuhësore dhe gramatikore të tekstit të vendimeve gjyqësore vlerësohet me 2.4 nga 3, që është kryesisht vetëm për shkak të gabimeve teknike dhe drejtshkrimore.

Megjithëse i pazbatueshëm si kategori e indikatorit në të gjitha aktgjykimet, udhëzimet e sakta dhe të qarta të gjykatës më të lartë në gjykatën më të ulët, dhe në rast të shfuqizimit dhe kthimit të aktgjyqimit të shkallës së parë të gjykatës themelore në vendimmarrje të sërishme, u vlerësua në vetëm një aktgjykim. Pikërisht për shkak të këtij fakti, vlerësimi nuk mund të merret si relevant, pasi nuk ka ekzemplar adekuat të aktgjyqimeve në bazë të të cilave do të mund të vlerësohet. Sidoqoftë, duke pasur parasysh që praktikë e ngjashme është hasur edhe në rajonet e tjera të apelit, vlen të përmendet se gjykata në këtë rast përdori fjali veçanërisht të përgjithshme, stereotipa "Gjatë veprimit të sërishëm, gjykata e shkallës së parë duhet të heqë shkeljen e konstatuar thelbësore të dispozitave të procedurës penale në mënyrën që në seancën e caktuar kryesore, pasi të jenë përbushur të gjitha parakushtet ligjore për mbajtjen e saj, do t'i paraqesë të gjitha provat e propozuara në bazë të të cilave do t'i përcaktojë të gjitha faktet vendimtare në lëndën dhe në varësi nga ajo që është përcaktuar, me zbatimin e duhur të së drejtës materiale të miratuarë vendim të drejtë dhe ligjor gjyqësor", që nuk jep pasqyrë të qartë të udhëzimeve të tij.

Në kushtet e shfuqizimit ose ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, aktgjykimet e Gjykatës së Apelit në Shkup u referohen arsyeve të shprehura qartë për këtë, prandaj edhe nota për këtë indikator është 5.2 nga 6.

Gjatë ndryshimit të vëllimit ose lartësisë së sanksionit, gjykata zakonisht jep arsye pse iu qas modifikimit të tillë të sanksionit, por shpesh këto janë arsyetime të standardizuara, për shembull se bëhet fjalë shpesh për vepër penale, kështu që shpeshësia e tij në periudhën konkrete ndikon në vendimin e tillë ose, megjithatë, që të njëjtat rrethana lehtësuese dhe rënduese vlerësohen ndryshe. Prandaj, nota për këtë indikator vlerësohet me 4.5 nga 6.

Detyrimi për të shqyrtuar të gjitha ankesat në procedurë, ndërsa më vonë edhe argumentimin e tyre përkatës në aktgjykimin e shkallës së dytë është kusht për vendim cilësor, i cili në fakt ishte edhe lëndë e shqyrtimit në përputhje me metodologjinë. Lidhur me këtë indikator, Gjykata e Apelit në Shkup u vlerësua me notën 5.3 nga 6, për shkak të faktit se ishin evidentuar aktgjykimet në të cilat nuk përfshihen ankesat e mbrojtjes në aktgjykimin e saj.

Duke pasur parasysh që zgjedhja e aktgjyqimeve në këtë rajon të apelit ka vetëm një aktgjykim për të cilin është i zbatueshëm indikatorin në lidhje me ndryshimin e tij, vlerësimi për të nuk do të ishte përkatës të merret si relevant në mungesë të ekzemplarit përfaqësues.

Indikatori i fundit i metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së aktgjykimeve të shkallës së dytë i referohet asaj nëse gjykata dhe në çfarë mase i kushton vëmendje afatit të parashikuar për parashkrimin absolut të ndjekjes penale për veprën penale konkrete, lëndë e diskutimit. Vlerësimi i kësaj kategorie supozon operacion kompleks nëse merret parasysh se përveç komponentit themelor - rrjedhës së kohës, është e domosdoshme të llogaritet edhe kompleksiteti i lëndës në aspektin e materialit të provave, sigurimin e tij, propozimin dhe realizimin, si dhe seriozitetin e veprës penale me të cilën ngarkohet. Në bazë të kësaj, vlerësimi modest i të gjitha këtyre parametrave që do të ndikonin në kohëzgjatjen e procedurës i referohet notës 4.6 nga 6.

Duke pasur parasysh vlerësimin e cilësisë përmes të gjithë indikatorëve të vendosur, indeksi i cilësisë në këtë rajon të apelit përcaktohet në 4.4.

## KONKLUZIONI DHE REKOMANDIMET

Aktgjykimet në rajonin e apelit në Shkup nuk devijojnë aspak nga standardet e parashikuara për strukturën dhe koherencën përkatëse, ose devijimi në të cilin shqiptimi i aktgjykimit nuk do të ishte në harmonizim logjik me arsyetimin ose do të ishte në kundërshtim.

Është konstatuar mungesa e arsytimit adekuat të rregullave juridike, në mënyrë që së bashku me gjendjen faktike të përcaktohet shqiptimi i aktgjykimit. Gjendja e konstatuar faktike, në korrelacion me zgjedhjen e normave juridike, lidhjen e tyre, përcaktimin e përmbajtjes dhe interpretimit, siç caktohet në metodologji, nuk mund të identifikohet plotësisht në të gjitha aktgjykimet. Në përgjithësi, kjo haset si mangësi në të gjitha rajonet e apelit dhe nevojitet të adresohet siç duhet për të tejkaluar këtë praktikë joadekuate.

Cilësia e arsytimeve dhe çështjeve hyrëse, si dhe zgjedhja e provave relevante dhe vlerësimi i tyre individual, me qëllim të përcaktimit të duhur të gjendjes faktike, por edhe arsytimeve të mëtejshme, veçanërisht ato që konsiderohen irelevante dhe që nuk ishin të rëndësishme dhe do të ndikonin për vendimmarrje të ndryshme, janë me cilësi të lartë.

Si rajon në të cilën përmirësimi është i domosdoshëm gjatë veprimit të gjykatave në këtë rajon të apelit është vëmendja e pamjaftueshme për deklaratat dhe pretendimet e palës që ka humbur kontestin, si dhe vlerësimi i argumenteve të kundërta. Pra, është e qartë që këto deklarata janë marrë parasysh, por nuk mund të jepet asnjë arsyetim thelbësor se pse nuk do të ishin. Është e nevojshme t'u kushtohet vëmendje identike rasteve kur si paditës i autorizuar paraqitet prokuroria publike në procedurë, gjatë së cilës miratohet aktgjykimi lirues ose aktgjykimi refuzues, kështu që evidentohet argumentimi i mbështetur nga e drejta e arsyetuar dhe materiale, sepse pretendimet e prokurorisë nuk merren parasysh, si dhe në rastet e tjera, kur hasen aktgjykimet dënuese, ku e drejta materiale nuk theksohet si mbështetje.

Pothuajse një e treta e aktgjykimeve të rajonit të apelit në Shkup në lidhje me zbatimin dhe prezantimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore dhe parimeve juridike nuk i përmbushin standardet minimale të cilësisë. Aktgjykimet që nuk i përmbushin standardet minimale nuk e trajtojnë detajisht veprën penale, karakteristikat dhe natyrën e saj, si dhe të mirën e mbrojtur. Në këto aktgjykime, haset vetëm neni i ligjit që tregon se për cilën vepër penale bëhet fjalë dhe se veprimet e të akuzuarit çojnë në drejtim të përmbushjes së natyrës së tij. Në bazë të gjendjes së konstatuar kështu, edhe në këtë rajon të apelit është e domosdoshme t'i kushtohet vëmendje argumentimit të plotë dhe përkatës në lidhje me veprën penale, lëndë e kontestit, si dhe lidhjen përkatëse të saj me veprimet e kundërligjshme të të akuzuarit, por edhe për të futur elementin me vlerë teorike të vendimit, në mënyrë që të mund të përdoret dhe referohet si praktikë e mirë gjyqësore në të ardhmen.

Aktgjykimet kanë nivel të lartë të qartësisë dhe qëndrueshmërisë, si dhe korrektësisë gjuhësore dhe gramatikore të tekstit të vendimeve gjyqësore.

### 1.3.4 Cilësia e vendimeve gjyqësore në rajonin e apelit në Shtip

Në kuadër të këtij rajoni të apelit, në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore, lëndë e analizës ishin gjithsej 12 aktgjykime, nga të cilat tetë ishin të Gjykatës Themelore në Shtip me departamentin në Probishtip dhe katër ishin të Gjykatës së Apelit në Shtip. Vlerësimet në përputhje me grupin e parë të indikatorëve që parashikojnë strukturën dhe koherencën përkatëse të vendimeve gjyqësore në këtë rajon, vendosjen e të gjitha pjesëve të nevojshme në to, si dhe strukturën e drejtë, me shqiptime të qarta dhe koncize që janë në harmonizim logjik me arsyetimin, tregojnë nivelin e lartë dhe cilësinë e përpunimit. Në bazë të së cilës edhe vlerësohen me notën më të lartë të parashikuar për këta indikatorë - 3, përkatësisht 6.

Subsumcioni i kryer siç duhet, më saktë nëse gjendja faktike konkrete e përcaktuar në aktgjykimet, duke zbatuar normat juridike që janë të zbatueshme për rastin konkret, prodhon veprime juridike është indikator tjetër me të cilin u vlerësuan këto vendime. Ishte vlerësuar nëse shqiptimi i aktgjykimit ka ndikuar në përmbajtjen e arsyetimit, që si elemente është e domosdoshme të lidhen dhe njëra të dalë nga tjetra, por edhe njëra të mos kundërshtojë tjetrën, duke siguruar qëndrueshmëri të vendimeve. Ajo që u konstatua gjatë shqyrtimit të aktgjykimeve ishte fakti se, ashtu si edhe gjykatat e tjera themelore, edhe ky nuk kushton vëmendje të mjaftueshme rregullave juridike, që së bashku me gjendjen faktike duhet të formulojnë shqiptimin. Për shkak të kësaj rrethane, nota e mesme për këtë indikator është përcaktuar në 6.4 nga 9. Pjesa tjetër në lidhje me vlerësimin e provave, si dhe konkluzionet në lidhje me faktet relevante, zgjedhjen dhe interpretimin e tyre, koherencën e arsyetimeve dhe argumentimin është në nivel të kënaqshëm.



Grupi i tretë dhe më kompleks i indikatorëve i referohet cilësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, përkatësisht ratio decidendi. Historiku dhe prezantimi i çështjes që është lëndë e përcaktimit, zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore relevante dhe parimeve juridike, si dhe i gjithë procesi për të konstatuar gjendjen faktike, përmes procedurës së provave, vlerësimit të argumenteve të kundërta dhe qartësisë dhe qëndrueshmërisë së arsyetimit janë parametrat kryesorë përmes të cilëve u vlerësuan indikatorët në këtë grup.

Hyrja përkatëse dhe e kuptueshme në çështjen që shqyrtohet, si dhe kronologjia e veprimeve të përshkruara në arsyetim, në këto aktgjykime vlerësohet me notën më të lartë 6. Faktet dhe rrethanat janë përshkruar që kapin qartë thelbin e lëndëve, me atë që dhe për secilën çështje është me kujdes të strukturohet në paragraf përkatës dhe të veçantë.

Indikator i që deri më tani është vlerësuar më dobët për këtë rajon të apelit, në përputhje me qasjen metodologjike, si dhe në rajonet e tjera të apelit - prezantimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore relevante dhe parimeve juridike dhe këtu nuk devijon nga nota e dobët. 1.5 nga 6 është nota e mesme për këtë indikator dhe kjo bazohet në praktikën e përdorimit të fjalisë së përgjithshme në të cilin futen vetëm të dhënat personale në lidhje me të akuzuarin dhe veprën, për shembull: "Në bazë të gjendjes faktike të përcaktuar kështu, gjykata konstatoi se në veprimet e të akuzuarit N.N. nga SH. përmbahen të gjithë elementët e rëndësishëm të veprës penale për veprën penale «Vjedhja e rëndë» nga neni 236 paragrafi 1 pika 1 në lidhje me nenin 19 të KP-së, për shkak që gjykata e shpalli të akuzuarin fajtor për këtë vepër penale dhe i shqiptoi dënimin si në shqiptimin e aktgjykimit. Në parim, kjo është gjithçka që gjykata ka deklaruar në lidhje me veprën penale, pa hyrë aspak në llojin e veprës, karakteristikat dhe natyrën e saj, veprimin e ekzekutimit, të mirën e mbrojtur ose shkeljen.

Rëndësia e provave, arsyetimi i tyre i hollësishëm, si dhe argumentimi pse disa do të trajtoheshin si irelevante, por edhe vlerësimi i provave përmes qasjes individuale, për secilën provë u vlerësua veçmas përmes indikatorit që e shqyrton gjendjen faktike dhe procedurën e provave. Sa i përket këtij indikator, nota e mesme është përcaktuar në 2.4 nga 3, që në parim nuk mund të trajtohet si cilësi e dobët e veprimit të gjykatave në këtë pjesë të aktgjykimit.

Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit, ndërsa pastaj edhe arsyetimit të të gjitha provave, gjykata ka për obligim jo vetëm t'i marrë parasysh edhe ato që dalin nga pala që ka humbur kontestin, por edhe t'i argumentojë në mënyrë përkatëse. Më saktë, gjykata është e detyruar të japë përgjigje se pse nuk konsiderohen relevante, si dhe ta mbështesë këtë qëndrim me të drejtën materiale të zbatueshme në kontekstin konkret. Duke qenë se nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve, gjysma, përkatësisht 50% e tyre, ishin aktgjykime në lidhje me procedurën në të cilën i akuzuari gjykohej në mungesë, gjykata nuk ishte në gjendje t'i shqyrtojë argumentet e kundërta për arsyen e thjeshtë që edhe avokatët që ishin emëruar me detyrë zyrtare, nuk ofruan as prova dhe as pretendime relevante në aspektin e mbrojtjes së teorisë së tyre të rastit. Por, në pjesën e mbetur të aktgjykimeve, 50% e mbetur, gjykata vlerësohet me notën më të lartë - 6. Vëmendja e duhur e kushtuar nga gjykata evidentohet në to, por edhe hapësira për arsyetimin e tyre.

Dy indikatorët e fundit i referohen qartësisë dhe qëndrueshmërisë së arsytimit të aktgjykimit, si dhe korrektësisë gjuhësore dhe gramatikore të tekstit të vendimit gjyqësor. I pari vlerësohet me 2.6 nga 3, për shkak të dobësive të shënuara për sa i përket koncizitetit të arsytimeve, deklaratave të kopjuara të dëshmitarëve në procedurë dhe vështirësisë në disa prej tyre për të ndjekur narrativin. Indikator i dytë dhe i fundit për vlerësimin e aktgjykimeve të gjykatave themelore i referohet kuptueshmërisë së tekstit të aktgjykimit, qartësisë së paragrafëve dhe fjalive, por edhe përdorimit të gjuhës letrare dhe drejtshkrimit, si dhe mungesës së gabimeve teknike. Vlerësimi për këtë indikator është 2.75, ndërsa ky është ulur nga nota më e lartë 3 për shkak të pranisë së gabimeve të shtypit dhe teknike, si dhe gabimeve gramatikore dhe drejtshkrimore.

Aktgjykimet e shkallës së dytë në këtë rajon të apelit, identike me ato të mëparshmet, u shqyrtuan përmes indikatorëve që parashikojnë silogjizëm juridik në subsumcion (logjikën juridike) dhe cilësinë e arsytimit të vendimit - ratio decidendi.

Cilësia e vendimeve përmes logjikës juridike vlerësohet me 8.25 nga 9, për shkak të mungesës së rregullave juridike në një nga vendimet që është lëndë e analizës. Aktgjykimet e mbetura përmbajnë parametra të domosdoshëm që e përbëjnë këtë indikator, evidentohen konkluzionet në lidhje me faktet relevante, si dhe zgjedhjen dhe interpretimin e tyre.

Qartësia dhe qëndrueshmëria e aktgjykimeve të shkallës së dytë vlerësohen me notën më të lartë për këtë indikator - 3 në këtë rajon të apelit, dhe në mënyrë identike edhe kategoria e korrektësisë gjuhësore dhe gramatikore të tekstit të vendimeve gjyqësore.

Indikator i në lidhje me ofrimin e udhëzimeve të sakta dhe të qarta për gjykatën më të lartë në gjykatën më të ulët, ndërsa në rast të shfuqizimit dhe kthimit të aktgjykimit të shkallës së parë në gjykatën themelore për vendimmarrje të sërishme, nuk u vlerësua sepse asnjë nga aktgjykimet e zgjedhura rastësisht gjykata më e lartë nuk vendosi që lëndën ta shfuqizojë dhe ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë për vendimmarrje të sërishme. Nga ana tjetër, indikator i në lidhje me vlerësimin e udhëzimeve të gjykatës më të lartë kur shfuqizohet ose ndryshohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë vlerësohet vetëm në një aktgjykim, dhe ai është me notën më të lartë të parashikuar - 3.

Ndryshimi në vëllimin ose lartësinë e sanksionit në aktgjykimet e vlerësuara nuk ishte shënuar, prandaj edhe ky indikator nuk vlerësohet për këtë rajon të apelit.

Duke i shqyrtuar veçmas, secila prej ankesave të theksuara në procedurë, gjykata në vendimin e saj të shkallës së dytë ka për obligim të japë përgjigje për secilën prej tyre, e cila u analizua nga aspekti i metodologjisë. Gjykata e Apelit në Shtip, në përputhje me këtë indikator, vlerësohet me notën 6 nga 6, me konstatimin se ankesat për të cilat është vepruar janë përfshirë plotësisht dhe ekziston arsyetim përkatës për to.

Vlerësimi i këshillit të gjykatës së shkallës së dytë të ankesave të paraqitura, si dhe përcaktimi i shkeljeve që gjykata e shkallës së dytë eventualisht do t'i vërente dhe vlerësonte me detyrë zyrtare, por edhe shqyrtimi veçmas i ankesave në procedurë, janë obligim ligjor për çdo gjykatës që vepron në shkallën e dytë. Në bazë të kësaj, aktgjykimet e Gjykatës së Apelit në Shtip u vlerësuan përmes indikatorëve përkatës dhe ato kanë notën më të lartë të përcaktuar në përputhje me këtë indikator.

Qasja metodologjike për vendimet e shkallës së dytë parashikon që gjatë ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, vendimi gjyqësor i gjykatës së apelit duhet t'i ketë të gjitha karakteristikat në përcaktimin e gjendjes faktike, analizën e provave, theksimin e së drejtës materiale dhe arsyetimin, si dhe për çdo vendim gjyqësor të shkallës së parë. Pasi ky indikator u kontrollua për matshmëri në aktgjykime, u përcaktua se ai mund të vendoset vetëm në një, pas së cilës, gjatë analizës së vendimit konkret, për këtë pjesë u vlerësua me notë 4 nga 6. Kjo është kryesisht për shkak të vëmendjes së pamjaftueshme që i kushtohet normës juridike, përkatësisht natyrës së veprës dhe elementeve të saj.

Indikator i fundit për përcaktimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore të shkallës së dytë i referohet rrethanës nëse gjykatat e apelit i kushtojnë vëmendje afatit të parashkrimit absolut të lëndës sipas së cilës veprohet. Ky indikator u shqyrtua si përmes rrjedhës së periudhës kohore gjatë procedurës, ashtu edhe përmes ndërlikueshmërisë së lëndës që analizohet, veçanërisht duke pasur parasysh vëllimin dhe "peshën" e materialit të provave, por edhe seriozitetin e veprës penale, përkatësisht lëndën e mbrojtjes. Megjithëse është jashtëzakonisht e vështirë të kuantifikohet nëpër numra veprimi i një gjykate në lidhje me këto parametra, pas shqyrtimit të kujdesshëm të lëndëve në këtë rajon të apelit, nota në lidhje me këtë indikator është 4 nga 6.

Duke pasur parasysh vlerësimin e cilësisë përmes të gjithë indikatorëve të vendosur, indeksi i cilësisë në këtë rajon të apelit përcaktohet në 4.4.

## KONKLUZIONI DHE REKOMANDIMET

Vendimet në këtë rajon kanë strukturë dhe koherencë përkatëse, por edhe shqiptime të qarta dhe koncize që janë në harmonizim logjik me arsyetimin. Por, ashtu si edhe gjykatat e tjera themelore, edhe kjo nuk u kushton vëmendje të duhur rregullave juridike që së bashku me gjendjen faktike duhet të formulojnë shqiptimin.

Arsyetimet e aktgjykimeve japin hyrje të përshtatshme dhe të kuptueshme për çështjen që shqyrtohet, si dhe kronologjinë e veprimeve, por edhe kanë kujdes që secila çështje të jetë e strukturuar dhe përpunuar me kujdes në paragraf të përshtatshëm dhe të veçantë.

Zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore relevante dhe parimeve juridike është problem që ekziston edhe në këtë rajon, ku evidentohet praktika e përdorimit të fjalive të përgjithshme brenda të cilave futen të dhënat personale për të akuzuarin dhe veprën, pa individualizimin e duhur.

Arsyetimi i hollësishëm, si dhe argumentimi për (pa)rëndësinë e disa provave duke përdorur qasjen individuale, evidentohet si praktikë joadekuate që e ul nivelin e cilësisë së vendimeve gjyqësore. Si rrjedhojë, është e domosdoshme t'i qasemi krijimit të praktikës në të cilën gjykata do t'i kushtojë vëmendje secilës provë veç e veç dhe në tërësi me të tjerat dhe për të cilën do të ketë arsyetim përkatës në lidhje me vlerën e saj provuese dhe rëndësinë për rastin konkret.

Në dallim nga disa prej gjykatave të tjera, në këtë është evidentuar praktika pozitive e shqyrtimit të të gjitha argumenteve të kundërta të palës që e humbi kontestin, si dhe siguroi hapësirë adekuate për arsyetimin e tyre.

Konciziteti i arsyetimeve, si dhe praktika e deklaratave të përsëritura të dëshmitarëve nga procesverbali, në aktgjykimin është fushë ku ka hapësirë për avancimin në kuadër të këtij rajoni të apelit. Por, edhe në përdorimin e gjuhës, përkatësisht rregullave drejtshkrimore, kur bëhet fjalë për gabimet e shtypit, teknike dhe gramatikore. Sidoqoftë, ky lloj i lëshimeve dhe vërejtjeve shënohen vetëm në nivelin e gjykatave themelore në këtë rajon, dhe jo në Gjykatën e Apelit.

Veprimi i gjykatës së shkallës së dytë, i shqyrtuar përmes indikatorëve të zbatueshëm nga metodologjia, i referohet veprimit të tij përkatës në përputhje me kompetencat e parashikuara në ligjin hetimor.

Cilësia e shqyrtimit të ankesave në procedurë është në nivel solid, ndërsa udhëzimet e dhëna nga gjykata më e lartë janë identike në rastet kur vendimi shfuqizohet dhe kthehet në vendimmarrje të sërishme të gjykatës më të ulët.

Gjatë vendimmarrjes meritore të gjykatës së shkallës së dytë, u konstatua standardi i pakënaqshëm kur bëhet fjalë për strukturën, si dhe arsyetimin e normës juridike, përkatësisht thelbit të veprës dhe elementeve të saj. Aktgjykimet e gjykatave më të larta, identike me ato më të ulëta, gjatë vendimmarrjes meritore duhet t'i përmbajnë të gjitha elementet dhe strukturën e plotë të një aktgjykimi. Në mënyrë plotësuese, me rëndësi të veçantë është t'u kushtohet vëmendja e mjaftueshme normave juridike në të cilat bazohet aktgjykimi, si dhe shpjegimi i tyre përkatës.

Lidhur me vëmendjen e duhur të gjykatës së shkallës së dytë, në afatin e parashkrimit absolut të lëndës sipas së cilës veprohet, është e pashmangshme të konstatohet se veprimi më efikas është i domosdoshëm me qëllim të zvogëlimit të rrezikut të parashkrimit të ndjekjes penale.

## 1.4 ANALIZA E CILËSISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE NË NIVELIN NACIONAL

### 1.4.1 Analiza sasiore

Indeksi i cilësisë me të cilin u vlerësuan vendimet gjyqësore në katër rajonet e apelit paraqet notën që merret pasi të mblidhen indekset e cilësisë të të gjitha vendimeve të analizuar gjyqësore në nivelin e rajonit të apelit, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për vendime të shkallës së parë apo të shkallës së dytë, dhe më pas të ndara nga numri i përgjithshëm i vendimeve të analizuar gjyqësore.

Në bazë të parimit të vlerësimit të vendosur kështu, secili prej vendimeve në rajonet konkrete të apelit u vlerësua në bazë të indikatorëve aplikativë të parashikuar në metodologji. Nota më e lartë, përkatësisht indeksi i cilësisë, i parashikuar në qasjen metodologjike është 5.4, duke marrë parasysh edhe përmbushjen e indikatorëve në gjykatat themelore, edhe në gjykatat e apelit. Si rrjedhojë, aktgjykimet nga rajoni i apelit në Manastir u vlerësuan me notë të mesme 4.6, që është në fakt më e larta nga të katër gjykatat e apelit, më tej aktgjykimet e rajonit të apelit në Gostivar u vlerësuan me notë të mesme 4.2, që është më e ulëta në krahasim me të tjerat, nga ana tjetër, aktgjykimet e rajoneve të apelit në Shkup dhe në Shtip u vlerësuan me notë 4.4. Kur shuma e këtyre indekseve të cilësisë nga rajone të ndryshme të apelit do të mblidhet, ndërsa pastaj edhe të ndahet me numrin e tyre, do të fitohet nota në nivel nacional që është 4.4.

### 1.4.2 Analiza cilësore

Duke i marrë parasysh konstatimet nga të katër rajonet e apelit, mund të konkludohet se në nivelin nacional, në pjesën dominuese, vendimet e gjykatave kompetente kanë strukturën e duhur, duke përfshirë edhe harmonizimin e plotë me standardet e parashikuara për faktin se cilat elemente duhet t'i përmbajë një aktgjykim. Ato ndiqen nga shqiptimet e qarta dhe koncize që janë në harmonizim logjik me arsyetimet dhe përfaqësojnë një tërësi koherente dhe jokontradiktore. Qartësia dhe konciziteti i pjesshëm dhe i pamjaftueshëm, por edhe strukturimi i aktgjykimeve është konstatuar në vendimet e shkallës së parë në nivelin e rajonit të apelit në Gostivar.

Ndoshta një nga pjesët më thelbësore të vendimeve, ekzistimi i logjikës juridike, përkatësisht arsyetimi përkatës i rregullave juridike, që të mund së bashku me gjendjen faktike të përcaktohet edhe shqiptimi i aktgjykimit, është sfidë e vërtetë në nivelin nacional. Sidomos nëse marrim parasysh nevojën, gjendjen e konstatuar faktike, në

korrelacion me zgjedhjen e normave juridike, lidhjen e tyre, përcaktimin e përmbajtjes dhe interpretimin e tyre, ashtu siç parashikohet, për t'u identifikuar si e pranishme në të gjitha aktgjykimet. Respektimi i plotë me ligjshmëritë logjike të miratimit të vendimit parashikojnë që është e nevojshme të përcaktohet nëse vendimi gjyqësor është subsumcioni i kryer si duhet, përkatësisht nëse gjendja faktike duke zbatuar normat juridike prodhon veprime juridike. Në bazë të kësaj qasjeje teorike-metodologjike, si konstatim në nivelin nacional, mund të konkludohet se gjykatat nuk i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme arsytimit më thelbësor dhe vendosjes së rregullave juridike në aktgjykimet. Norma juridike në fjalë duket më shumë si tezë e supozuar dhe e pranuar përgjithësisht që nuk duhet të shpjegohet në detaje, në mënyrë që të jetë në gjendje të lidhë dy postulatet kryesore përmes silogjizmit, në mënyrë që të miratohet konkluzioni.

Cilësia e arsytimeve në aktgjykimet në nivelin nacional është në nivel relativisht të mirë kur merret parasysh zgjedhja e provave relevante dhe vlerësimi i tyre individual, me qëllim që të përcaktohet si duhet gjendja faktike, por edhe arsytimet e mëtejshme, veçanërisht ato që konsiderohen të parëndësishme dhe të cilat nuk ishin me rëndësi dhe do të ndikonin në vendimmarrjen e ndryshme. Në përgjithësi, arsytimet e aktgjyqimeve ofrojnë hyrje të përshtatshme dhe të kuptueshme për çështjet që shqyrtohen, si dhe narracion sistematik dhe kronologjik të të gjitha veprimeve të ndërmarra, si dhe përshkrim të fakteve dhe rrethanave, duke dhënë një pamje të qartë të lëndëve sipas së cilave veprohet.

Nga ana tjetër, dinamika e paragrafëve, megjithëse parashikohet të ndjekë konceptin - një çështje juridike, një paragraf, i cili do të ishte i qartë dhe konciz, i përbërë nga fjali të qarta dhe të kuptueshme në mënyrë optimale, nuk mund të përcaktohet si përgjithësisht pozitiv në kuadër të të gjitha rajoneve të apelit, me të edhe në nivelin nacional. Kjo për shkak se akoma ekziston praktika e mbivlerësimit të tërësive individuale - paragrafëve që duhej të trajtojnë segmente të ndryshme të gjendjes faktike ose provave në lidhje me të. Dobësitë e vendosura në këtë drejtim i referohen nevojës për t'i ndryshuar praktikatat individuale në rajone të caktuara dhe lëshimin e tyre gradual, në mënyrë që të rritet niveli i cilësisë së arsytimeve të përgatitura dhe të lehtësohet shumë navigacioni përmes narrativës së ofruar në aktgjykime.

Mbase në pjesën e parëndësishme, megjithatë, në një pjesë të aktgjyqimeve në nivelin nacional evidentohet mungesa e arsytimit të hollësishëm, si dhe argumentimi i (pa) rëndësisë së provave duke përdorur qasjen individuale për secilën prej tyre. Dhe kjo në një shkallë të caktuar e zvogëlon nivelin e cilësisë së vendimeve gjyqësore. Mungesa e arsytimeve të hollësishme për faktin pse disa nga provat nuk janë të argumentuara, as nuk jepet arsytimi se pse nuk konsiderohen të rëndësishme, paraqet devijim nga parimi në pajtim me të cilin gjykata është e detyruar të vlerësojë veçmas secilën provë dhe në lidhje me provat e tjera, prandaj në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë konkluzion nëse ndonjë fakt do të konsiderohet i dëshmuar apo jo dhe nëse mbi të do ta bazojë aktgjykimin. Në mënyrë plotësuese, në këtë lidhet vetëm praktika në disa vendime të

përsëritjes së përmbajtjes së plotë të deklaratave të dëshmitarëve në procedurat e dhëna në procesverbal, si dhe krijimin e grupeve të provave që analizohen në tërësi, dhe jo individualisht. Këto situata i referohen domosdoshmërisë për respektimin konsekuent të dispozitave të ligjit hetimor, në pajtim me të cilin gjykata do t'i kushtojë vëmendje secilës provë veç e veç dhe si në tërësi me të tjerat dhe për të cilën do të ketë arsyetim përkatës në lidhje me vlerën e tij të provës dhe rëndësinë mbi rastin konkret. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që kredibiliteti dhe ligjshmëria e një aktgjykimi t'i përfshijë të gjitha provat e propozuara dhe të paraqitura, të cilat do të arsyetohen në mënyrë përkatëse.

Në pjesën e arsytimit të vendimeve gjyqësore është përfshirë edhe segmenti i procedurës së provës që i referohet argumentimit të kundërt të palës që e humbi kontestin. Kjo është, gjithashtu, e vendosur si rajon ku vendimet në pjesën më të madhe të rajoneve të apelit është e domosdoshme të ndër marrin masa për avancim. Ajo që gjendet si mangësi është se nuk ka arsyetim thelbësor për të mos marrë parasysh këto argumentime. Në këto situata është e nevojshme t'u kushtohet vëmendje identike argumenteve dhe mbështetjes së tyre me të drejtën materiale, pavarësisht se për cilën palë në procedurë bëhet fjalë - nëse është përfaqësuesi i autorizuar i prokurorisë apo i akuzuari.

Si një nga problemet thelbësore të vërejtura gjatë zbatimit të këtij hulumtimi është mungesa e praktikës së shpjegimit të përshtatshëm ose në disa raste edhe çfarëdo shpjegimi të normës juridike për secilën çështje që është lëndë e diskutimit. Në mënyrë identike, fakti që gjykatat rrallë i kushtojnë vëmendje shtjellimit të hollësishtëm të veprës penale, karakteristikave dhe natyrës së saj, si dhe lëndës së mbrojtjes, përkatësisht së mirës së mbrojtur, është dukshëm problematik. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre aktgjykimeve ofrojnë vetëm një nen të ligjit që tregon për cilën veprë penale bëhet fjalë, si dhe lidhje të shkurtër me veprimet e të akuzuarit që çojnë në drejtim të përmbushjes së natyrës së tij. Në rritjen e nivelit të cilësisë së aktgjykimeve, sigurisht që do të kontribuonte edhe referenca eventuale ndaj praktikës vendase ose praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, diçka që deri më tani është hasur vetëm në një aktgjykim nga të gjitha 62 të trajtuarat. Në bazë të kësaj, me rëndësi të jashtëzakonshme do të ishte të arrihej shkalla e barazisë solide në veprimet e gjykatësve individualë që argumentojnë në detaje dhe me arsyetim, si normat hetimore, ashtu edhe normat materiale, në mbështetje të konfirmimit ose refuzimit të tezës së prokurorisë. Në mënyrë plotësuese, argumentimi i plotë dhe përkatës në lidhje me veprën penale, lëndë e kontestit, si dhe lidhja e tij me veprimet e kundërligjshme, por edhe pasurimi i vendimit duke futur elementin e perspektivës teorike, mund të kontribuojnë në përdorimin dhe referimin e tij në të ardhmen si praktikë e mirë gjyqësore. Në këtë mënyrë, do të shmanget përdorimi i fjalive të përgjithshme, brenda të cilave, nëse është e nevojshme, të dhënat personale të të akuzuarit dhe vepra do të ndryshohen, pa individualizimin përkatës, dhe të cilat janë mjaft të pranishme në vendimet.

Përshtypja fillestare e vendimeve në nivelin nacional është se ato nuk kanë nivel mjaft të kënaqshëm të korrektësisë gjuhësore dhe gramatikore. Gjatë shkrimit, u përdor dialekti lokal, që është karakteristik për disa pjesë të vendit, ndërsa evidentohen edhe lëshime të caktuara gjatë aplikimit të drejtshkrimit maqedonas. Kuptohet, kjo nuk është përshtypje e përgjithshme për të gjitha rajonet e apelit, as vendimet, përjashtim nga ky është rajoni i apelit në Shkup, si dhe vendimet e gjykatave të shkallës së dytë, por ajo që është e përbashkët për të gjithë është nevoja urgjente për vëmendje për minimizimin e rrezikut të krijimit të gabimeve të shtypit dhe teknike gjatë hartimit të vendimeve.





# REKOMANDIMET

Në programet e Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, të miratuar për përsosjen e vazhdueshme profesionale të kuadrit të jurisprudencës, është e domosdoshme të kushtohet më shumë vëmendje dhe trajnime të detyrueshme që i referohen arsytimit të drejtë dhe të strukturuar të vendimeve gjyqësore. Duke pasur parasysh konstatimin e misionit vlerësues të TAEKS-it se "Programet e trajnimit të vazhdueshëm janë në thelb teorike dhe akademike dhe nuk ka shumë punëtori të vërteta për marrjen e aftësive praktike"<sup>15</sup>, është e pashmangshme të konstatohet se aftësitë praktike të gjykatësve nuk janë në nivel të kënaqshëm, dhe posaçërisht në pjesën e strukturimit përkatës të vendimeve. Si rrjedhojë, është e domosdoshme të përfshihen komponentët në programet që kanë plotësuar njohuritë e gjykatësve ekzistues, në mënyrë që të avancohet edhe cilësia e përgatitjes së vendimeve gjyqësore.

Mungesa e kuadrit në gjykata, veçanërisht të gjykatësve në përputhje me sistematizimet e parashikuara të vendeve të punës në nivelin e gjykatave themelore, çon në mënyrë të pashmangshme në situatën në të cilën gjykatësit e emëruar kanë sfidë për të tejkaluar kuotën e parashikuar të lëndëve të zgjidhura. Vëllimi joproporcional i punës, përkundër numrit aktiv të gjykatësve, çon në zvogëlimin e cilësisë së vendimeve, veçanërisht nëse marrim parasysh kohën në të cilën pritet të përfundojë një lëndë, dhe pastaj vendimi i marrë bazuar në të gjitha kriteret dhe parimet e përcaktuara për sa i përket arsytimit të tij, dhe njëherazi do të sigurojë nivel të lartë të cilësisë së zbatimit dhe argumentimit të së drejtës materiale, mbështetjen e tij teorike, por edhe zbatimin praktik, si vendas, ashtu edhe të GJEDNJ-së. Në bazë të kësaj, është e domosdoshme që pas vlerësimit përkatës të mungesës së resurseve njerëzore, përkatësisht gjykatësve, Këshilli Gjyqësor i RMV-së t'i qaset procesit të zgjedhjes së tyre, në mënyrë që në ndonjë masë dhe tërthorazi të ndikojë në cilësinë e punës së tyre, me të edhe në pjesën teknike - hartimin e vendimeve.

Gjykatat themelore në vend është e domosdoshme t'u kushtojnë vëmendje gjatë proceseve konsultative të kolegjiemeve të tyre, me qëllim që t'i shqyrtojnë problemet eventuale në lidhje me cilësinë e vendimeve gjyqësore, për të përcaktuar praktikë identike të vendosjes kur bëhet fjalë për këtë pjesë teknike të kryerjes së punës së tyre dhe me të ta avancojnë cilësinë e hartimit të vendimeve gjyqësore.

Në kuadër të takimit konsultativ të punës të zhvilluar me përfaqësuesit e gjykatave në të gjitha shkallët, si rekomandime dhe konkluzione në lidhje me avancimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore, u ngrit çështja për domosdoshmërinë e ngritjes së cilësisë së vendimeve gjyqësore në nivelin e të gjitha rajoneve të apelit në vend. U theksua nevoja për vëmendje të veçantë për t'i ndjekur standardet e përcaktuara se si duhet të duken vendimet, të cilat do të minimizonin mundësinë e ndikimit kreativ të gjykatësve, por edhe nevojën për argumentimin e duhur dhe rëndësinë e provave, si dhe referimin e praktikës vendase ose praktikës gjyqësore ndërkombëtare. Vëmendja e veçantë i është kushtuar

15 TAEKC Peer Review on Judicial Training for Judges and Prosecutors in the former Yugoslav Republic of Macedonia, Mission timeframe: from 23/04/2018 to 26/04/2018, Authors of the report: Judge Lennart Johansson and Judge Dragomir Yordanov.

pjesës që i detyron gjykatësit të mos devijojnë nga identiteti i domosdoshëm objektiv midis aktgjykimit dhe akuzës, kështu që në kushtet e ndjekjes së përkrahjeve të gjera të veprave dhe rrethanave të aktakuzës, në mënyrë të pashmangshme kontribuon në koncizitetin e pamjaftueshëm dhe në aktgjykimin. Prandaj, konstaton se është e domosdoshme t'i qaset përmirësimit dhe avancimit të dispozitivit të akuzave për shkak se vetëm në atë mënyrë gjykatat mund të rrisin nivelin e cilësisë dhe vendimeve të tyre.

Në drejtim të asaj që është thënë më lartë, u propozua ideja e hartimit të udhëzimit për shkrimin e aktgjykimeve, që do t'i kushtonte vëmendje edhe strukturës së aktgjykimeve (shqiptimit, arsytimit dhe vështimit të elementeve të nevojshme, përfshirë edhe zbatimin e praktikës), veçanërisht duke marrë parasysh llojet e ndryshme të aktgjykimeve që gjykatat i miratojnë - aktgjykimi pranues, aktgjykimi dënues, aktgjykimi lirues ose aktgjykimi refuzues. Ndërsa, në kuadër të aktgjykimeve dënuese në të cilat parashikohet shqiptimi i ndonjë lloji të sanksionit, të përcaktohen kriteret e qarta për caktimin e sanksioneve bazuar në provat e paraqitura, si dhe matjen e dënimeve, në të cilat do të merren parasysh edhe raportet e vlerësimit të rrezikut dhe vlerësimit përfundimtar nga shërbimet e provës.

Me qëllim që të rritet cilësia e vendimeve në nivel më të lartë, u dha propozim-rekomandimi në drejtim të caktimit të gjykatësve mentorë, të cilët do të ishin gjykatës me përvojë dhe njohuri shumëvjeçare, ndërsa ishin kompetentë ekskluzivisht për mbikëqyrjen dhe mentorimin e kolegëve më të rinj. Këta gjykatës do të transferonin vazhdimisht njohuritë e fituara dhe do të ishin mekanizëm kontrollues për cilësinë e punës së të rinjve.

Me ndikim të veçantë në cilësinë e aktgjykimeve ishte edhe roli i Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë (AGJPP), përmes trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme, të parashikuara në kuadër të saj. Është theksuar se është e domosdoshme të ndryshohet qasja dhe mënyra e kryerjes së trajnimeve për shkak se është vjetruar dhe ngarkuar me teori në krahasim me praktikën e nevojshme për gjykatësit dhe prokurorët publikë të ardhshëm. Ndryshimi i qasjes duhet të përfshijë një përqindje të lartë (80-90%) të kurrikulës që përbëhet nga trajnime praktike, gjykime të simuluar që zhvilloheshin vazhdimisht, si dhe përgatitjen e aktgjykimeve për rastet konkrete. Ndërsa trajnimet të kryhen nga ligjërues me përvojë, të cilët do të jenë të aftë në transferimin e njohurive të tyre, si te gjykatësit / prokurorët publikë, ashtu edhe te bashkëpunëtorët profesionistë, si forcë shtytëse në procesin e hartimit të vendimeve.

Rekomandimi ishte konstatuar edhe për Ministrinë e Drejtësisë, e cila është kompetente dhe me rëndësi të veçantë për alokimin e vëllimit përkatës të mjeteve për punësim, përveç gjykatësve dhe prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionistë, për arsyen e thjeshtë se janë jashtëzakonisht të rëndësishme në plotësimin përkatës të resurseve njerëzore në jurisprudencë. Pra, në vitet e fundit është konstatuar fluksi

i kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë publikë në AGJPP, që në kohën e duhur do të plotësoheshin vendet e lira të punës për këto dy kategori profesionistësh, dhe kështu në mënyrë proporcionale, largimi i bashkëpunëtorëve profesionistë dhe kuadrit profesional që do të vazhdonte të punonte në kuadër të këtyre institucioneve. Prandaj, me rëndësi të madhe është planifikimi përkatës i kuadrove profesionale në jurisprudencë, si dhe alokimi i mjeteve nga buxheti për këtë qëllim.



---

**BARAZIMI I  
VENDIMEVE GJYQËSORE –  
STUDIMI I RASTIT**

Sistemi i jurisprudencës i Maqedonisë parashikon që Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut është gjykata më e lartë në vend dhe ajo e siguron unitetin në zbatimin e ligjeve nga gjykatat. Në bazë të kompetencave dhe rolit që ka gjykata më e lartë në vend, mund të konstatohet se ajo është përgjegjëse permanente për avancimin e praktikës gjyqësore, më saktë të sigurimit të unitetit në zbatimin e ligjeve nga gjykatat.

Sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve, Gjykata Supreme e realizon përmes miratimit, përkatësisht duke krijuar qëndrime parimore, mendime juridike parimore për çështje të caktuara juridike që janë të detyrueshme për këshillat e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat kanë ndikim ose janë të detyrueshme për gjykatat më të ulëta në vend, në mënyrë që të avancojnë praktikën gjyqësore, përkatësisht zbatimin e harmonizuar të ligjeve. Me mendimet juridike parimore të miratuara në Mbledhjen e Përgjithshëm të Gjykatës Supreme, ajo, si gjykata më e lartë në vend, kontribuon në zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme juridike për të cilat në vendimmarrje, jo vetëm që i shtjellon dispozitat ligjore që janë lëndë e shqyrtimit, por edhe lëndë e elaborimit dhe arsyetimit është fryma e ligjit në kontekstin konkret, parimi, si dhe vlerat që këto dispozita i mbrojnë në interes të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, barazisë së qytetarëve para ligjit, por edhe sigurisë juridike në një rend juridik.

Në kuadër të kësaj gjykate, është themeluar departamenti i veçantë për ndjekjen e praktikës gjyqësore, qëllimi kryesor i të cilit është barazimi dhe ndjekja e praktikës gjyqësore në vend, dhe për të arritur unitetin në zbatimin e ligjeve dhe për të siguruar barazinë e qytetarëve dhe barazinë e tyre para ligjit, që është një tjetër "filtër" për kontrollimin e barazimit të praktikës gjyqësore.

Nuk ka dyshim për rëndësinë dhe rolin e Gjykatës Supreme në vend në sigurimin e praktikës gjyqësore të qëndrueshme, me të edhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, duke siguruar barazi para ligjit, si siguri juridike. Sidoqoftë, është fakt që të gjitha çështjet juridike nuk mund të jenë ose janë lëndë e harmonizimit nga Gjykata Supreme e RMV-së ose ka iniciativa për barazim në disa rajone konkrete. Kjo është pikërisht arsyeja pse, për nevojat e pjesës së dytë të kësaj analize, pjesa e vlerësimit të barazimit u qas me qasje tjetër, përmes zbatimit të metodës së studimit të rastit. Pra, në aspektin e materies juridike-penale, Gjykata Supreme bashkon çështje që në përputhje me udhëzimet e parashikuara në metodologjinë sipas së cilës ishte përgatitur analiza, nuk do t'i referoheshin ekzemplarit përfaqësues mjaft të madh që reflektonte zbatimin e praktikës identike në gjykatat, vendimet e të cilave u analizuan. Në bazë të kësaj, duhej t'i qasej aspektit tjetër të analizës, në kuadër të së cilës vlerësohej dhe analizohej barazimi i vendimeve gjyqësore në përputhje me një çështje unifikuese për të cilën kishte numër të mjaftueshëm të vendimeve të gjykatave të ndryshme themelore dhe gjykatave të apelit - parimi Non bis in idem.

## VËREJTJET HYRËSE

Parimi *Non bis in idem* është parimi i përgjithshëm në të drejtën penale, pjesë e shumë sistemeve juridike, ndërsa në disa edhe i kodifikuar në nivelin e kategorisë kushtetuese. Në të njëjtën kohë, është vendosur edhe si e drejtë individuale brenda kornizës së mekanizmave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Ky parim përbëhet nga dy komponentë që pasqyrojnë thelbin e tij: *Nemo debet bis vexari pro una et eadem causa* - askush nuk mund të ndiqet penalisht dy herë për të njëjtën veprë; dhe *Nemo debet bis puniri pro uno delicto* - askush nuk mund të dënohet dy herë për të njëjtën veprë. Në disa vende, ky parim është i kufizuar në mundësinë e dënimit të dyfishtë, përkatësisht mbrojtjen nga ai. Arsytimi për zbatimin e këtij parimi është i ndryshëm. Ky ndalim i mbron qytetarët nga e drejta e pakufizuar shtetërore për dënim (*ius puniendi*) dhe në të njëjtën kohë mundëson respektimin e rregullit që çdo lëndë vendimtare konsiderohet e vërtetë (*res iudicata pro veritata habetur*), me çka mundësohet legjitimiteti i sistemit juridik në një shtet.<sup>16</sup> Në bazë të kësaj, karakteristikat dhe arsyet më të rëndësishme të parimit, të cilat theksohen në vendet e veçanta, janë se parimi nënkupton mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore, mbrojtjen e individit nga keqpërdorimi i shtetit, drejtësisë, ndershmërisë, proporcionalitetit, sigurisë juridike, efikasitetit hetimor, respektimit mbi *res iudicata*.

Parimi *Non bis in idem* në sistemin tonë fillimisht bazohet si parim kushtetues dhe parashikohet në nenin 14, paragrafi 2 të Kushtetutës, në të cilën qëndron se "askush nuk mund të gjykohej përsëri për veprën për të cilin tashmë është gjykuar dhe për të cilin është miratuar vendimi gjyqësor i formës së prerë". Sidoqoftë, mbrojtja dhe zbatimi i mëtejshëm i tij sigurohet në ligjet materiale dhe hetimore që rregullojnë materien penale-juridike. Pra, neni 7 i Ligjit për procedurë penale parashikon ndalimin e gjykimit të dyfishtë ose dënimit, me ç'rast theksohet se "Askush nuk mund të gjykohej ose të dënohej përsëri për veprën për të cilin tashmë është gjykuar dhe për të cilin është miratuar vendimi gjyqësor i formës së prerë.", ndërsa në Ligjin për kundërvajtje, neni 101 paragrafi 1 a.3 ligjvënësi parashikoi që "Gjykata që e mban procedurën e kundërvajtjes me aktvendim do të ndërpresë procedurën nëse: për të njëjtën veprë është ngritur procedurë penale deri në përfundimin e procedurës penale" ose personi do të lirohet nga ndjekja penale për kundërvajtje nëse tashmë është sanksionuar për veprën penale me tipare identike.

Këto dispozita ndiqen vetëm nga dispozitat ndërkombëtare, të parashikuara nga neni 4 i Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, të cilat parashikojnë "1. Askush nuk mund të nxirret para gjykatës ose të dënohet përsëri në procedurë penale në kompetencë të shtetit të njëjtë për veprën penale për të cilin është liruar nga akuza, ose i dënuar në pajtim me ligjin ose procedurën penale të atij shteti (...)" . Që ky parim të prodhojë veprim, është e nevojshme të kemi vendim gjyqësor të formës së prerë me të cilin personi lirohet ose dënohet në

16 John A. E. Vervaele, The transnational *Non bis in idem* principle in the EU Mutual recognition and equivalent protection of human rights, *Utrecht Law Review*.

lidhje me të njëjtën çështje juridike në momentin kur kundër personit përsëri ngrihet procedura penale ose shqiptohet sanksioni penal.<sup>17</sup>

Në sistemin tonë juridik, veprat penale janë të degëzuara dhe të ndara në dy kategori: veprat penale dhe kundërvajtjet. Njëra kategori perceptohen si më të rënda dhe si materie janë të rregulluar me të drejtën penale, ndërsa kategoria tjetër, që teoria i identifikon si më të lehta ose më pak të rrezikshme, janë lëndë rregullimi me të drejtën e kundërvajtjes. Ajo që është specifike për këto kategori në dukje identike është fakti se edhe pse kanë nocione dhe strukturë identike, në disa prej tyre është evidente edhe përputhja e natyrës juridike të veprave penale dhe kundërvajtjeve të caktuara.

Kjo është arsyeja pse GJEDNJ-ja i është qasur degëzimit dhe zbatimit të këtij parimi kur bëhet fjalë për këto dy kategori të veprave penale. Pra, me lëndën *Zolotukhin v. Russia*<sup>18</sup>, Këshilli i Madh Gjyqësor i GJEDNJ-së e hodhi bazën për degëzimin, përkatësisht përcaktimin e çështjes identike të veprës. Në këtë rast, si pikë fillestare është marrë “çështja identike materiale” e veprës, që nënkupton ndalimin e një personi që të ndiqet ose sanksionohet për veprën të bazuar në të njëjtat fakte dhe rrethana si edhe për veprën për të cilin tashmë është gjykuar, respektivisht dënuar. Me këtë rast ndërlidhet edhe lënda e *Maresti v. Croatia*<sup>19</sup>, në të cilën personi fillimisht u dënua për kundërvajtje, ndërsa më pas edhe për veprën penale për të njëjtën ngjarje (sulm fizik ndaj personit), prandaj Gjykata konstatoi se bëhet fjalë për të njëjtën vepër (idem) dhe se sanksioni penal ishte përsëritja e dënimit (bis).

Si një nga lëndët më të rëndësishme në jurisprudencën e GJEDNJ-së, që përcakton kritere individuale për të përcaktuar nëse ka shkelje të parimit të *Non bis in idem*, është lënda *Engel and others v. the Netherlands*<sup>20</sup> në të cilën përcaktohet se në rastet në të cilat të dyja procedurat që mbahen kundër personit të caktuar janë penale sipas së drejtës pozitive të shtetit, ndërsa si kritere shtesë shtohen edhe “natyra” e shkeljes, si dhe niveli i ashpërsisë së sanksionit të shqiptuar, bëhet fjalë për shkeljen e këtij parimi. Në bazë të këtyre kritereve shtesë, në praktikën e GJEDNJ-së ka raste të shumta kur edhe në procedurat administrative, procedurat e kundërvajtjes, etj., u konstatua ekzistimi i *Non bis in idem* gjatë përplasjes së procedurave të tilla me procedurën penale.

Duke pasur parasysh pabarazinë e pjesshme të veprimit të gjykatave themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe veçanërisht kur bëhet fjalë për parimet e vendosura si në të drejtën vendase, ashtu edhe në të drejtën ndërkombëtare, ky studim do të analizojë zbatimin e parimit *Non bis in idem* përmes prizmit të dhjetëra vendimesh gjyqësore, njëri prej të cilëve është referent, ndërsa përmes parimit të barazimit të tyre. Më saktë, do të përcaktojë se si veprojnë gjykatat themelore dhe gjykatat e apelit në RMV kur është fjala për këtë parim, nëse ka dallime në praktikë dhe për çfarë vlejné ato.

17 Prof. Dr. Gordan Kallajxhiev etj., *Komentimi i Ligjit për procedurë penale* – Shkup, 2018.

18 Lënda *Zolotukhin v. Russia*, aplikacioni nr. 14939/03.

19 Lënda *Maresti v. Croatia*, aplikacioni nr. 55759/07.

20 Lënda *Engel and others v. the Netherlands*, aplikacioni nr. 5100/71; 5101/71; 5102/71; 5354/72; 5370/72.



## FAKTET RRETH RASTEVEE

**1. Me aktgjykimin III K. nr. 1746/1 nga 05.09.2018 të Gjykatës Penale Themelore në Shkup** (atëherë Gjykata Themelore Shkup 1, Shkup), për të akuzuarin është refuzuar akuza në pajtim me nenin 402 paragrafi 1 pika 5 të Ligjit për procedurë penale në lidhje me nenin 4 të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, sepse i akuzuari për të njëjtën vepër tashmë është dënua në formën e prerë.

Pra, kundër të akuzuarit në këtë lëndë është ngritur padi penale private nga i dëmtuari, me të cilën ngarkohet se "pa asnjë shkak dhe arsye, iu është afruar të dëmtuarit nga prapa dhe ka filluar ta ngufat në pjesën e qafës, duke e goditur me duar në pjesën e kokës, pas së cilës i dëmtuari nga goditjet e forta ka rënë në tokë duke rënë me anën e djathtë të trupit në beton, ndërsa i akuzuari ka vazhduar ta godas me këmbën e djathtë në pjesën e trupit, pas së cilës i dëmtuari, duke u përpjekur për të ikur, u drejtua kah dalja e sheshit të lojërave, por i akuzuari e ka mbërritur dhe e ka goditur me këmbën e djathtë në pjesën e ljevë, duke e ofenduar dhe kërcënuar me jetë, duke i shkakuar lëndime trupore të shprehura në formën e mavijosjeve në kokë, qafë dhe shpinë, mavijosje në të dy parakrahët, gërvishtje në lëkurën e shpinës dhe parakrahun e djathtë dhe reagim të fuqishëm të stresit Dg. Contusio capitis, coll et dorsi, contusion antebracii, bill. Excoriafionescutis dorsi et antebrodivi dex, F 43 acute stress reaction".<sup>21</sup> Me veprimet e përshkruara në këtë mënyrë, supozohet se i akuzuari do të kryente veprën penale "Lëndim trupor" sipas nenit 130 paragrafi 1 të KP-së.

Arsyeja e refuzimit të akuzës në këtë rast konkret është ekzistimi, përkatësisht procedura tashmë e kryer e kundërvajtjes 11 PRK J 1056/17-J me aktgjykim të formës së prerë më 10.04.2018, me të cilin i akuzuari u shpall fajtor për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike në pajtim me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për kundërvajtje kundër RQP-së, për të cilën ndaj tij është shqiptuar sanksioni i kundërvajtjes - gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë me denarë prej 24,400 denarë.

**2. Me aktgjykimin V K. nr. 1828/15 nga 10.07.2020 në Gjykatën Penale Themelore në Shkup**, për të akuzuarin është refuzuar akuza në pajtim me nenin 402 paragrafi 1 pika 5 të Ligjit për procedurë penale, sepse i akuzuari për të njëjtën vepër tashmë ka shqiptuar vendim meritore, me të cilën lirohet nga akuza.

Më saktë, me padinë penale private të ngritur kundër të akuzuarit, ai akuzohet për atë se "pas diskutimit të shkurtër paraprakë mbi parkimin e PMV në pronësi të paditësit privat, e sulmoi atë fizikisht duke i dhënë tre goditje me dorën e bërë grusht në pjesën e kokës duke i shkakuar lëndim trupor në formën e shtypjes në kokë, në të njëjtën mënyrë e sulmoi edhe paditësin e dytë privat, i cili u përpoq t'i ndante, duke i dhënë një goditje me dorën e bërë grusht në pjesën e kokës dhe fytyrës nga ana e majtë duke i shkakuar

21. Aktgjykimi III K. nr. 1746/17 nga 05.09.2008 i Gjykatës Penale Themelore në Shkup.

lëndim trupor të shprehur në formën e inflamacionit në anën e majtë të fytyrës”.<sup>22</sup> Me veprimet e përshkuara në këtë mënyrë, supozohet se i akuzuari do të kryente veprën penale "Lëndim trupor" sipas nenit 130 paragrafi 1 të KP-së.

Arsyeja për refuzimin e akuzës në këtë rast konkret është aktgjykimi i miratuar i Gjykatës Penale Themelore Shkup 017 PRK-J-1292/15 nga 03.12.2019, me të cilin i akuzuari është liruar nga përgjegjësia për faktin se gjatë procedurës së kundërvajtjes janë miratuar ndryshime ligjore për sa u përket afateve të parashkrimit të mbajtjes së procedurës së kundërvajtjes, përkatësisht për kundërvajtjen me të cilën akuzohet i akuzuari se ka ndodhur parashkrimi për mbajtjen e procedurës së kundërvajtjes.

**3. Me aktgjykimin KZH-270/19 nga 09.04.2019 të Gjykatës së Apelit në Shkup** është refuzuar ankesa e Prokurorisë Publike në Veles kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Veles me të cilën refuzohet akuza kundër të akuzuarit për veprën penale "Lëndim trupor" sipas nenit 130 paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1 të KP-së, në përputhje me 402 pika 5 të LPP-së, sepse i akuzuari për të njëjtën veprë tashmë është dënuar në formën e prerë në procedurën e kundërvajtjes.

**4. Me aktvendimin KZH-291/20 nga 22.12.2020 të Gjykatës së Apelit në Shtip**, hme rastin e ankesës së të akuzuarit dhe me detyrë zyrtare aktgjykimi i Gjykatës Themelore Shën Nikollë K. 11/20 nga 28.10.2020 shfuqizohet dhe lënda kthehet në gjykatën e shkallës së parë për vendimmarrje të sërishme. Kjo ndodh sepse gjykata konstatoi "se i akuzuari u dënua si për kundërvajtjen, ashtu edhe për veprën penale "Lëndim trupor" sipas nenit 130 paragrafi 1 të KP-së, i cili lejoi që i akuzuari të mbante përgjegjësi dy herë, një herë përgjegjësi për kundërvajtje dhe herën e dytë përgjegjësi penale, dhe në lidhje me të njëjtën procedurë, përkatësisht veprimet e njëjta, të cilat janë ndërmarrë në të njëjtën kohë, në të njëjtin vend ndaj të njëjtës palë të dëmtuar, përkatësisht elementet e natyrës së kundërvajtjes së konstatuar janë të njëjta me natyrën e veprës penale për të cilin akuzohet dhe anasjelltas."<sup>23</sup>

**5. Me aktgjykimin KZH-74/19 nga 27.02.2019 të Gjykatës së Apelit në Gostivar** është refuzuar ankesa e paditësit privat kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gostivar me të cilin i akuzuari e refuzoi akuzën për veprën penale "Lëndim trupor" sipas nenit 130 paragrafi 1 të KP-së, ndërsa në përputhje me nenin 402 paragrafi 1 pika 5 të LPP-së. Kjo për faktin se për të njëjtën ngjarje, që ndodhi në të njëjtën ditë, vendimi gjyqësor i formës së prerë është miratuar në Gjykatën Themelore në Tetovë PRK-J-64/17 nga 30.05.2017, i cili u bë i plotfuqishëm më 20.07.2017, për kundërvajtje të dënueshme sipas nenit 12 paragrafi 1 të LKKRQP-së. Për shkak të kësaj rrethane, ekzistimi i aktgjykimit të formës së prerë të miratuar në procedurën e kundërvajtjes, për të njëjtën ngjarje dhe të njëjtat fakte ndaj të të akuzuarve të njëjtë, gjykata e refuzoi akuzën pas

<sup>22</sup> Aktgjykimi V K. nr. 1828/15 nga 10.07.2020 i Gjykatës Penale Themelore në Shkup.

<sup>23</sup> Aktgjykimi KZH-291/20 nga 22.12.2020 i Gjykatës së Apelit në Shtip.

padisë penale private, sepse në mënyrë të padiskutueshme përcaktoi se të akuzuarit për të njëjtën ngjarje u liruan nga përgjegjësia duke pasur parasysh që procedura e kundërvajtjes që u mbajt kundër të të akuzuarve ka natyrë penale-juridike, në kuptimin e nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së dhe praktikës së GJEDNJ-së.

**6. Me aktgjykimin K-519/17 nga 09.11.2018 të Gjykatës Themelore në Manastir**, akuzuari, përkundër ekzistimit të aktgjykimit të formës së prerë PRK-J. nr. 150/17, nga 26.01.2017, me të cilin u shpall fajtor për prishjen e rendit dhe qetësisë publike duke sulmuar fizikisht të dy fëmijët dhe i është shqiptuar sanksioni i kundërvajtjes gjorbë me 600 euro, ai u shpall fajtor dhe i është shqiptuar masa alternative - dënimi me kusht, me të cilin i përcaktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej pesë muajsh, që nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej dy vitesh nuk kryen veprë të re penale. Ai u shpall fajtor sepse “pa asnjë shkak dhe arsye sulmoi fizikisht fëmijën në mënyrën që, ndërsa fëmija ishte mbështetur në biçikletë, i akuzuari e kapi fëmijën për qafe dhe filloi ta ngufat, pas së cilës e ka shtyrë, nga e cila e shtyrë fëmija ka rënë mbi biçikletë, drejtpërdrejt në ijën e djathtë, me të cilat veprime të të akuzuarit, fëmija ka marrë lëndime trupore të shprehura në formën e shtypjes në pjesën e qafës dhe shtypjes në pjesën e ijës në anën e djathtë. Me këto veprime, për të akuzuarin u konstatua se ka kryer veprë penale ‘Lëndim trupor’ sipas nenit 130, paragrafi 1 të KP-së.”<sup>24</sup>

Arsyetimi i dhënë nga gjykata për këtë vendim është: “Nga ana tjetër, e padrejta nga kjo dispozitë, neni 12 paragrafi 1 të LKKRQP-së nuk konsumohet dhe e padrejta nga neni 130 paragrafi 1 të KP-së. Kjo dispozitë i referohet veprimit që është vepra penale lëndimi trupor, nënkupton të padrejtën e madhe në lidhje me kundërvajtjen si veprim penal, dhe kryhet nga ai që do të dëmtojë fizikisht ose do të prish shëndetin e tij. Kjo veprë ekziston nëse me veprimin e kryerësit shkakton lëndim trupor ose prishet shëndeti i viktimës, pavarësisht në cilin vend është kryer, në vend publik apo jo, për shembull, në shtëpi, objekt... Objekti i mbrojtur i këtij inkriminimi është integriteti trupor i viktimës, i cili me veprimin e kryerësit prishet ose dëmtohet. Për këto arsye, nuk mund të konsiderohet se i akuzuari që është dënuar për kundërvajtje sipas nenit 12 paragrafi 1 të LKKRQP-së, nuk mund të dënohet edhe për veprë penale lëndim trupor sipas nenit 130 paragrafi 1 të KP-së”.<sup>25</sup>

**7. Me aktgjykimin K. nr. 237/16 nga 19.09.2016 të Gjykatës Themelore në Shtip**, i cili u miratua pas pranimit të të akuzuarit, gjykata konstatoi fajësinë tek ai dhe “e dënoi me 80 (tetëdhjetë) gjoba ditore në vlerë prej 320 euro në kundërvlerë me denarë prej 19,680.00 denarë, në të cilën gjobë të akuzuarit i llogaritet gjoba e shqiptuar në vlerë prej 300 euro në kundërvlerë me denarë prej 18,450.00 denarë me aktgjykimin e kësaj gjykate PRK-J nr. 21/16 nga 03.05.2016, në mënyrë që të akuzuarit i mbetet të paguajë shumën prej 1,230,00 denarë. I

<sup>24</sup> Aktgjykimin K-519/17 nga 09.11.2018 i Gjykatës Themelore në Manastir.

<sup>25</sup> Ibid.

akuzuari është dënuar sepse pas përplasjes së shkurtër verbale, ai sulmoi fizikisht paditësin privat në mënyrën që e goditi me grusht në pjesën e syve dhe e goditi dy-tre herë në pjesën e trupit, duke i shkakuar kështu lëndime trupore në formën e mavijosjes në pjesën e qepallës së djathtë, skuqje në pjesën e syrit të djathtë dhe gjakderdhje në syrin e djathtë. Me këto veprime, gjykata konstatoi se i akuzuari ka kryer veprën penale ‘Lëndim trupor’, neni 130, paragrafi 1 të KP-së.”<sup>26</sup>

Gjykata në këtë rast konkret e pranoi pranimin e fajit nga i akuzuari pavarësisht faktit se ai duhej t’i kishte kushtuar vëmendje ekzistimit të parimit res judicata, në këtë rast aktgjykimi i miratuar në procedurën e kundërvajtjes, që është pjesë e materialit të provave në aktgjykimin penal. Në mënyrë plotësuese, i akuzuari në këtë lëndë nuk kishte as mbrojtës i cili mund ta këshillonte, dhe në fund të mbronte të drejtat e të akuzuarit, diçka që gjykata supozohet ta bëjë në përputhje me rolin e saj në sistemin e shtetit, që të mund në tërësi të njihet me të drejtat që i ka në procedurën penale dhe çfarë do të thotë të pranosh fajin në këtë rast. Si rrjedhojë, nuk është e qartë pse gjykata, duke e pasur parasysh procedurën e mëparshme për kundërvajtje, përfshirë edhe dënimin e të akuzuarit, iu qas kësaj faze të procedurës dhe lejoi pranimin e fajit, duke qenë se ky lloj shkeljeje përfshihet në pjesën e shkeljeve të së drejtës materiale dhe është bazë për procedurën ankimore, si dhe bazë për refuzimin e akuzës.

**8. Me aktgjykimin KZH-149/19 nga 19.04.2019 të Gjykatës së Apelit në Shtip,** ankesat e paditësit privat dhe të akuzuarit u refuzuan si të pabaza, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë të Gjykatës Themelore në Koçani K. nr. 289/18 nga 19.02.2019, me të cilin i akuzuari u shpall fajtor për veprën penale “Lëndim trupor” sipas nenit 130 paragrafi 1 të KP-së, ku u shqiptuan 15 gjoba ditore, vlera e gjobës ditore u caktua në 10 euro dhe u gjykua me dënim monetar prej 15 gjobave ditore në shumë prej 150 euro në kundërvlerë me denarë prej 9.225,00 denarë është konfirmuar.

Gjykata e shkallës së dytë e jep arsyetimin e mëposhtëm për këtë vendim: “Këto ankesa u refuzuan nga kjo gjykatë në tërësi si të pabaza për arsyet e mëposhtme: Pra, i akuzuari në procedurë të kundërvajtjes, që u mbajt para Komisionit për Kundërvajtje, Departamentit për Kundërvajtje K. - MPB K., u shpall fajtor për kundërvajtje sipas nenit 11 paragrafi 1 të LKKRQP-së, ku objekt i mbrojtjes është mbrojtja e rendit dhe qetësisë publike të qytetarit në vend publik, ndërsa në procedurën penale në fjalë i akuzuari u shpall fajtor për veprën penale ‘Lëndim trupor’ sipas nenit 130 paragrafi 1 të KP-së, ku objekt i mbrojtjes është mbrojtja e jetës dhe trupit të qytetarit, dhe ku i akuzuari, me veprimet e kundërligjshme të përcaktuara saktë në shqiptimin e aktgjykimit të shkallës së parë, e lëndoi trupin e të dëmtuarit. Në rastin konkret, nuk mund të bëhet fjalë për gjykim të dyfishtë, përkatësisht dënim të dyfishtë për të njëjtën veprë, siç është deklaruar nga i akuzuari, sepse duke i pasur parasysh faktet e mësipërme, bëhet fjalë për dy procedura të ndara, njëra është procedurë gjyqësore, ndërsa tjetra është procedurë e mbajtur para organit të kundërvajtjes, Komisionit për Kundërvajtje në MPB-në me objekt të ndryshëm

<sup>26</sup> Aktgjykimi K. nr. 237/16 nga 19.09.2016 i Gjykatës Themelore në Shtip.

mbrojtjeje, vendimi i Komisionit për Kundërvajtje nuk është vendim gjyqësor i formës së prerë në kuptim të nenit 7 të LPP-së. Në procedurën e kundërvajtjes, që nuk është procedurë gjyqësore, mbrohet rendi dhe qetësia publike e qytetarit në vend publik, ndërsa në procedurën penale të ngritur sipas padisë penale private të paditësit, mbrohet integriteti trupor i qytetarit.<sup>27</sup>

**9. Me aktgjykimin KZH-148/19 nga 23.04.2019 të Gjykatës së Apelit në Shtip,** ankesat e të akuzuarve u refuzuan si të pabaza, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë të Gjykatës Themelore në Koçani me të cilin ata u shpallën fajtorë për veprën penale "Lëndim trupor" sipas nenit 130 paragrafi 1 në lidhje me nenin 22 të KP-së, është konfirmuar. Me aktgjykimin e shkallës së parë të të akuzuarve, pavarësisht ekzistimit të procedurës së kundërvajtjes që përfundoi me aktgjykim, me të cilën i është shqiptuar gjoja e kundërvajtjes në shumë prej 200 euro për kundërvajtjen e kryer nga neni 11 paragrafi 1 të LKKRQP-së, pavarësisht konstatimit të gjykatës se veprimet e deklaruara të kundërvajtjes përkojnë me veprimet e deklaruara në padinë penale private, të akuzuarve u shqiptua masa alternative - dënimi me kusht, me të cilin u konstatua dënimi me burgim në kohëzgjatje prej dy muaj, në të njëjtën kohë u përcaktua se dënimi me burgim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit nuk kryejnë vepër të re penale brenda një viti nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Arsyetimi i gjykatës së shkallës së dytë është se "në rastin konkret u miratua vendimi - aktvendimi i Komisionit për Kundërvajtje në MPB, dhe nuk bëhet fjalë për vendim gjyqësor të formës së prerë në kuptimin e nenit 7 të LPP-së dhe në kuptimin e nenit 4, protokollit nr. 7 të Konventës së lartpërmendur për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Ai vendim - aktvendim është miratuar nga organi i kundërvajtjes - procedura e kundërvajtjes - Komisioni për Kundërvajtje. Sipas kësaj, nuk mund të zbatohet dispozita ligjore e nenit 7 të LPP-së dhe nenit 4, protokollit 7 të Konventës Evropiane të lartpërmendur".<sup>28</sup>

**10. Me aktgjykimin KZH-295/19 nga 17.09.2019 të Gjykatës së Apelit në Shtip,** ankesa e të akuzuarit u refuzua si e pabazë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë të Gjykatës Themelore në Shtip me të cilin i akuzuari u shpall fajtor për veprën penale "Lëndim trupor" nga neni 130 paragrafi 1 të KP-së dhe i gjykuar me dënim monetar prej 80 gjobash ditore në shumë prej 240 euro në kundërvlerë me denarë prej 14,760.00 denarë, përkundër ekzistimit të aktgjykimit me të cilën u shpall fajtor për kundërvajtjen e kryer dhe në përputhje me të i dënuar, është konfirmuar.

Gjykata e miratoi këtë vendim me arsyetimin e mëposhtëm: "Për këtë gjykatë, është e papranueshme ajo që u tha në ankesë se ekziston shkelje të nenit 7 të LPP-së, sepse në lidhje me kundërvajtjen e nenit 12 paragrafi 1 të LKKRQP-së dhe veprës penale

27 Aktgjykimi KZH-149/19 nga 19.04.2019 i Gjykatës së Apelit në Shtip.

28 Aktgjykimi KZH-148/19 nga 23.04.2019 i Gjykatës së Apelit në Shtip.

nga neni 130 paragrafi 1 të KP-së, bëhet fjalë për delikte të kundërligjshme me shkallë të ndryshme të inkriminimit objektiv (delikti kundërligjor i normuar si kundërvajtje, përkatësisht delikti i kundërligjshëm i nominuar si vepër penale), mënyra e ndryshme e ekzekutimit (sulm fizik në vend publik në lidhje me kundërvajtjen, përkatësisht lëndimi trupor ose dëmtimi i shëndetit në lidhje me veprën penale nga neni 130 paragrafi 1 të KP-së) dhe objektit të ndryshëm të mbrojtjes. Me natyrën e përcaktuar ligjërisht të kundërvajtjes nga neni 12 paragrafi 1 të LKKRQP-së, objekti i mbrojtjes është rendi dhe qetësia publike, ndërsa me natyrën e përcaktuar ligjërisht të veprës penale nga neni 130 paragrafi 1 të KP-së, që i përket grupit të veprave penale kundër jetës dhe trupit, objekti i mbrojtjes është integriteti trupor i njeriut. Për këto arsye, ankesat për shkeljen e kryer nga neni 7 të LPP-së janë të pabaza, sepse bëhet fjalë për delikte të ndryshme kundërligjore me objekt të ndryshëm të mbrojtjes dhe jo për të njëjtën vepër penale siç përcaktohet në nenin 7 të LPP-së.<sup>29</sup>

## ÇËSHTJA JURIDIKE

Në këtë rast konkret, lënda e vlerësimit nga gjykatat duhet të jetë nëse paditë private të palëve të dëmtuara janë parashtruar për sjelljen e njëjtë të të akuzuarve pavarësisht nga kualifikimi ligjor për sjelljen e tillë, përkatësisht nëse ekziston idem factum. Si do që të përcaktohet nëse në këto raste për të njëjtat fakte për të cilat mbahen dy procedura është e nevojshme të ketë dënim të dyfishtë, përkatësisht sanksionimin e të akuzuarit, dhe duke pasur parasysh faktin se i akuzuari tashmë është gjykuar dhe dënuar në formën e prerë ose, në rastet konkrete ka bazë për zbatimin e parimit Non bis in idem, dhe për shkak të ekzistimit të parimit juridik res judicata.

Kjo çështje juridike duhet të përgjigjet nga gjykatat përmes elaborimit dhe thirrjes së dispozitave, si nga e drejta vendase, ashtu edhe nga e drejta ndërkombëtare. Pra, duke u nisur nga referimi në nenin 2 paragrafi 1 të Ligjit për gjykata, në të cilin përcaktohet se gjykatat gjykojnë dhe i bazojnë vendimet e tyre në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën, pas së cilës roli i tyre mbrojtës në zbatimin e së drejtës gjendet në paragrafin 2 të të njëjtit nen, ku thuhet se në zbatimin e së drejtës gjykata i mbron të drejtat dhe liritë e njeriut.

Kjo pasohet nga një sërë dispozitash, si kushtetuese, ashtu edhe ligjore, në të cilat përcaktohet se "askush nuk mund të gjykohet përsëri për veprën për të cilën tashmë është gjykuar dhe për të cilën është miratuar vendim gjyqësor i formës së prerë", neni 14 paragrafi 2 të Kushtetutës së RMV-së, si dhe ndalimin e gjykimit ose dënimit të dyfishtë, i cili përcakton se askush nuk mund të gjykohet ose dënohet për veprën për të cilën tashmë është gjykuar dhe për të cilën është miratuar vendim gjyqësor i formës së prerë,

<sup>29</sup> Aktgjykimi KZH-295/19 nga 17.09.2019 i Gjykatës së Apelit në Shtip.

neni 7 të LPP-së, për shkak të së cilës përcaktohet se gjykata do të shqiptojë aktgjykim që refuzon akuzën nëse i akuzuari për të njëjtën vepër tashmë është dënuar në formën e prerë, lirohet nga akuza ose procedura kundër tij është ndërprerë në formën e prerë me aktvendim - neni 402 paragrafi 1 pika 5 të LPP-së.

Më tutje, duke theksuar të drejtën materiale në përputhje me të cilën këto veprime parashikohen si vepra penale, gjykata pritet t'i referohet nenit 130 paragrafi 1 të Kodit Penal, të vendosur në Kapitullin e Katërmbëdhjetë me titull "Veprat penale kundër jetës dhe trupit", ku përcaktohet se vepra penale sipas kësaj dispozite kryhet nga "Ai që tjetër do të lëndojë trupin ose do të dëmtojë shëndetin", ku përcaktohet se kryerësi do të dënohet me dënim monetar ose me burgim deri në tre vjet. Sidoqoftë, në mënyrë identike duhet të jepet shpjegimi i nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike, ku përcaktohet se kundërvajtja nga kjo dispozitë është kryer nga ai "Që sulmon fizikisht person tjetër në vend publik do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 600 deri në 800 euro në kundërvlerë me denarë". Kjo ndodh sepse është veçanërisht e rëndësishme të bëhet krahasimi dhe të shihet se kundërvajtja nga neni i sipërpërmendur nga LKRQP-ja është vendosur kryesisht për shkak të garantimit dhe mbrojtjes së dinjitetit njerëzor dhe sigurisë dhe rendit dhe qetësisë publike, por duke pasur parasysh përshkrimin e veprimit të kundërligjshëm në përputhje me të cilën sanksionohet sulmi fizik në vendin publik, nuk përjashtohet mbrojtja e njëkohshme e integritetit trupor të njeriut, të cilat vlera i përkasin rregullisht edhe sferës së mbrojtjes dhe së drejtës penale, siç është inkriminimi sipas nenit 130 paragrafi 1 të KP-së, i cili jo vetëm që e mbron interesin privat, por mbi të gjitha, edhe interesin publik. Fakti që kundërvajtja është më e lehtë sipas karakterit të vetë nuk e përjashton në vetvete kualifikimin e saj si vepër penale në kuptim të Konventës, duke pasur parasysh që qëllimi i dënimit, edhe në procedurën e kundërvajtjes, edhe në procedurën penale është dënim për veprën e kryer dhe parandalim i sjelljes së sërishme penale.

Duke pasur parasysh se në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës së RMV-së, marrëveshjet ndërkombëtare që janë ratifikuar në përputhje me Kushtetutën, janë pjesë përbërëse e rendit të brendshëm dhe nuk mund të ndryshohen me ligj, që do të thotë se janë me fuqi më të madhe juridike sesa ligjet dhe zbatohen drejtpërdrejt, në mënyrë plotësuuese që RMV-ja e ka nënshkruar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut me protokollet shtesë të Konventës, në këtë rast konkret, padyshim do të zbatohet neni 4 i Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut - E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë për të njëjtën vepër, e cila parashikon që "askush nuk mund të nxirret para gjykatës ose të dënohet përsëri në procedurën penale në kompetencë të të njëjtit shtet për veprën për të cilën është liruar përfundimisht nga akuza ose, i dënuar në përputhje me ligjin ose procedurën penale të atij shteti".

Në raste të tilla dhe të ngjashme, gjatë veprimit të gjykatave është e domosdoshme dhe duke u udhëhequr nga "kriteret e Engelit", të përcaktuara dhe të vendosura në lëndën Engel and Others v. the Netherlands<sup>30</sup>, për të bërë pyetjen: Nëse të dyja veprimet ishin penale në natyrën e tyre? Zbatueshmëria e parimit Non bis in idem është e mundur për rastet në të cilat të dy procedurat që janë mbajtur ishin penale sipas së drejtës pozitive të shtetit, por si kriteret shtesë përfshihet edhe "natyra", përkatësisht karakteri i veprës, si dhe pesha e dënimit për të cilën i akuzuari mund të ekspozohet ose niveli i ashpërsisë së sanksionit të shqiptuar. Jurisprudenca e GJEDNJ-së identifikon shumë lëndë kur edhe në procedurat administrative, procedurat e kundërvajtjes, madje edhe procedurat disiplinore, është konstatuar ekzistimi i parimit Non bis in idem kur u gjendën në përplasje me procedurën penale.

Më tutje, është veçanërisht e rëndësishme të përcaktohet nëse bëhet fjalë për të njëjtën vepër në të dy procedurat që mbahen (Idem), si dhe nëse ka pasur dy procedura për të njëjtën vepër (Bis). Në lëndën Sergey Zolotukhin v. Russia<sup>31</sup>, GJEDNJ-ja përcakton se ndalimi i rigjyimit duhet të interpretohet si ndalim i ndjekjes ose gjykitimit të individit për "veprën" e dytë në bazë të fakteve që thelbësisht janë të njëjta si në "veprën" e parë për të cilën ai tashmë është i dënuar në formën e prerë. Ndërsa, në lidhje me mbajtjen e dyfishtë të procedurave, është e domosdoshme të përcaktohet ekzistimi ose jo i kësaj rrethane në bazë të statusit juridik të procedurës fillestare (aktgjykitimit), më saktë nëse është bërë i formës së prerë ose përfundimtar.

Përveç zbatimit të parimit Non bis in idem, ndërsa në aspekt të statusit juridik të aktgjykitimit të parë, është veçanërisht e rëndësishme të konstatohet se garancia e parashikuar në nenin 4 të Protokollit nr. 7 të Konventës bëhet e rëndësishme dhe e zbatueshme në fillim të ndjekjes së re penale, kur aktgjykimi lirues ose dënues i mëparshëm bëhet sipas fuqisë së vet juridike res judicata, është i përvokueshëm dhe për të nuk ekzistojnë mjete të tjera juridike në dispozicion, pavarësisht nga fakti se aktgjykimi i mëparshëm është kundërvajtës dhe procedura e mëvonshme që ngrihet kundër të akuzuarit është penale, nëse bëhet fjalë për të njëjtën ngjarje penale-juridike dhe të njëjtat fakte me të cilat akuzohet i akuzuari.

30 Lënda Engel and Others v. the Netherlands, aplikacioni 5100/71; 5101/71; 5102/71; 5354/72; 5370/72.

31 Lënda Sergey Zolotukhin v. Russia [GC], aplikacioni nr. 14939/03.



## CPROCEDURA GJYQËSORE - ARGUMENTIMI I GJYKATAVE

BNë pesë lëndët e para të shqyrtuara, gjykatat konstatuan ose konfirmuan, në varësi të shkallës së veprimit, çështjen identike të fakteve dhe ekzistimin e idem factum, përkatësisht gjykatat konstatuan se ishte fakt i padiskutueshëm që bëhet fjalë për të njëjtën ngjarje që ndodhi në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend. Më saktë, kryerësi i kundërvajtjes në procedurën e kundërvajtjes paraqitet si person i akuzuar në procedurën penale, ndërsa personi i dëmtuar ka status identik, si në procedurën e kundërvajtjes, ashtu edhe në procedurën penale, ndërsa vendndodhja e veprimeve të ndërmarra korrespondon me të dyja procedurat. Gjykatat përcaktuan çështjen identike të fakteve edhe në aspekt të pasojave të veprës së kryer nga i dëmtuari, ndërsa të shqyrtuara përmes prizmit të objektit të mbrojtjes dhe obligimit për kthimin e tyre si kompensim i barabartë i të dëmtuarit nga veprimi i kundërligjshëm i kryerësit, që është një nga qëllimet e mbrojtjes juridike që e gëzon personi i dëmtuar. Konkretisht, i dëmtuari në njërin nga pesë lëndët ku zbatohet parimi Non bis in idem, ndërsa në njërin nga dy lëndët ku gjykata e shkallës së parë ka vepruar, me aktgjykimin e kundërvajtjes për kërkesën eventuale të dëmeve u dërgua në procedurë kontestimore nga gjykata, që padyshim tregon për faktin të dëmtuarit i është dhënë mbrojtje juridike dhe i është dhënë mundësia që të realizuar kompensimin e barabartë nga veprimi i kundërligjshëm i të akuzuarit, që sipas qëllimit të tij është identik me qëllimin e mbajtjes së kësaj procedure penale. Sidoqoftë, në mënyrë identike edhe në lëndën e dytë nga këto dy lëndë të shkallës së parë, pavarësisht që akuza ndaj të akuzuarit është refuzuar, gjykata që ka vendosur në procedurën penale e dërgoi të dëmtuarin në përputhje me nenin 114 të LPP-së, për të realizuar kërkesën pronësore-juridike në kontest.

Gjatë fazës së vlerësimit të veprimeve të të akuzuarit në procedurën e kundërvajtjes dhe procedurën penale, gjykatat në këto pesë lëndë konstatuan se bëhet fjalë për prishjen e rendit dhe qetësisë publike me veprimet e sulmit fizik ndaj të dëmtuarit, të cilat njëherazi janë lëndë edhe të padisë penale private sipas së cilës mbahet procedura penale për lëndimet trupore të shkaktuara ndaj të dëmtuarit. Gjykata konstatoi se edhe në veprimet e sulmit fizik ekziston identiteti dhe çështja identike, ndërsa për shkak të ekzistimit të disa veprimeve të njëpasnjëshme të ndërmarra nga i akuzuari, të cilat kualifikohen si sulm fizik. Si rrjedhojë, gjykata e përcakton sulmin fizik në përputhje me përshkrimin ligjor si element thelbësor / konstitutiv të kundërvajtjes të parashikuar dhe sanksionuar në nenin 12 të LKRQP-së, dhe i njëjti sulm fizik është lëndë e procedurës penale dhe në përputhje me certifikatën mjekësore, një pjesë e shkresave të lëndës, kualifikohet si lëndim trupor. Me ç'rast konstatohet se bëhet fjalë për ekzistimin e unitetit të pandashëm të fakteve në lidhje me kohën, vendin dhe mënyrën e veprimeve të ndërmarra të ekzekutimit, që synojnë të njëjtin objekt të mbrojtjes - integritetin trupor të qytetarëve.

Gjykata, gjithashtu, i kushtoi vëmendje vlerësimit nëse përkojnë qëllimet e përcaktuara të dënimit në procedurën e kundërvajtjes dhe procedurën penale. Konkretisht, për sjelljen e kundërligjshme të përdorimit të forcës fizike ndaj personit tjetër - të dëmtuarit, me çka është cenuar rendi dhe qetësia publike, i akuzuari ishte sanksionuar tashmë, me ç'rast me sanksionin e shqiptuar - gjobë në procedurën e kundërvajtjes për të akuzuarin, gjykata vlerësoi se qëllimet e njëjta të dënimit do të përmbushen, si në planin e parandalimit të veçantë, ashtu edhe në planin e parandalimit të përgjithshëm.

Në bazë të fakteve dhe rrethanave të verifikuara, ndërsa bazuar në teorinë, por edhe praktikën - si vendase, ashtu edhe GJEDNJ-së, gjykata në këto pesë lëndë vlerësoi se në rastin konkret padia penale private është parashtruar për të njëjtat fakte, përkatësisht faktet që janë në thelb të njëjta me faktet për të cilat është ngritur dhe përfunduar në formën e prerë procedura e kundërvajtjes, në të cilën është miratuar aktgjykimi i formës së prerë me të cilin i akuzuari tashmë është shpallur fajtor dhe sanksionuar për sjelljen e tij të kundërligjshme ose është liruar nga akuza. Pasi vërtetoi ekzistimin (idem factum) e identitetit të fakteve në mes të aktgjykimit për kundërvajtje dhe padisë penale private sipas së cilës u mbajt procedura penale, gjykata vendosi të refuzojë akuzën, duke e mbështetur vendimin e saj në parimin Non bis in idem, dhe më pas duke pasur parasysh se bëhet fjalë për çështjen e gjykuar (res iudicata). Kjo ndodh sepse për të njëjtat fakte, përkatësisht për faktet që janë në thelb të njëjta, i akuzuari tashmë është gjykuar dhe dënuar ose liruar nga akuza me aktgjykim të formës së prerë dhe ekzekutiv të miratuar në procedurën e kundërvajtjes, që më tutje nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta juridike. Në këtë ndërlidhet edhe situata kur ekziston vendimi me të cilin në formën e prerë ka përfunduar procedura e kundërvajtjes ose ndonjë procedurë tjetër penale për arsye që pengon përgjithmonë mbajtjen ose vazhdimin e saj (për shembull, parashkrimi). Të gjitha këto rrethana përfaqësojnë një nga kushtet për zbatimin e parimit juridik res iudicata, sepse për të vlerësuar ekzistimin e këtij parimi, është i rëndësishëm përfundimi në formën e prerë të procedurës para çdo organi, që me ligj ka kompetencë për të shqiptuar dënime, më pas duke mos u lidhur domosdoshmërisht për gjykatën.

Duke pasur parasysh se kundërvajtja nga neni 12 paragrafi 1 të LKRQP-së, për të cilin i akuzuari është shpallur fajtor dhe sanksionuar në formën e prerë, është vendosur në mënyrë primare me qëllim të garantimit dhe mbrojtjes së dinjitetit dhe sigurisë njerëzore dhe rendit dhe qetësisë publike, në mënyrë plotësuese parashikon edhe sanksionimin e sulmit fizik në vend publik, me çka nuk e përjashton edhe mbrojtjen e njëkohshme të integritetit trupor të njeriut, padyshim i referohet dhe e përfshin inkriminimin e parashikuar në nenin 130 paragrafi 1 të KP-së, me të cilën akuzohet i akuzuari në procedurën penale. Në mënyrë plotësuese, në rastin konkret, fakti që kundërvajtja është më e lehtë në karakterin e vet, vetvetiu nuk e përjashton kualifikimin e saj si vepër penale në kuptim të Konventës, duke pasur parasysh që në disa sisteme juridike janë përfshirë edhe kundërvajtje të caktuara që kanë konotacion penal, por janë shumë të rëndomtë për t'u përfshirë me ligjin penal dhe me procedurën penale.<sup>32</sup>

<sup>32</sup> Lëndët Menesheva v Russia, aplikacioni nr. 59261/00, Ziilberg v Moldavia, aplikacioni nr. 61821/00.

Në bazë të asaj që u tha më lartë, gjykata me të drejtë në pesë aktgjykimet e para konstatoi se sjellja e të akuzuarit që çoi në parashtrimin e kërkesës për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes dhe miratimin e aktgjykimit të kundërvajtjes në formën e prerë me të cilin i akuzuari u shpall fajtor dhe u dënua është e njëjta sjellje e përshkruar në padinë penale private me rastin e së cilës është inicuar procedura e mëvonshme penale. Në këtë ndërlidhet edhe situata e konstatuar në të cilën procedura penale është mbajtur, ndërsa me rastin e parashtrimin të padisë penale private kundër të akuzuarit, mbahet për të njëjtën ngjarje, në aspektin e kohës, vendit dhe mënyrës së kryerjes, përkatësisht sjelljes së njëjtë të të akuzuarit, në të njëjtën periudhë kohore, në të njëjtin vend, ku si pjesëmarrës në ngjarje paraqiten personat identikë që kanë status identik dhe më pas të njëjtat pasoja kanë ndodhur nga ngjarja. Prandaj edhe e refuzoi akuzën kundër të akuzuarit për veprën e theksuar penale.

Në grupin e dytë prej pesë lëndësh, gjykatat themelore, si dhe gjykatat e apelit që kanë vepruar në to, kanë qëndrim dhe arsyetim diametralisht të kundërt për zbatueshmërinë e këtij parimi në procedurat penale, të cilave u kanë paraprirë procedurat e kundërvajtjes të përfunduara në formën e prerë.

Pra, gjykatat në këto pesë lëndë i kategorizojnë qartë veprat penale, pavarësisht nëse bëhet fjalë për kundërvajtje ose vepër penale, ato i përcaktojnë në përputhje me ligjet konkrete, por bëjnë dallimin në lidhje me objektin e mbrojtjes. Kundërvajtja përkufizohet si veprim me të cilin fizikisht sulmohet personi në vend publik, me ç'rast objekti i mbrojtjes është rendi dhe qetësia publike në shoqëri, dhe në mënyrë plotësuese, sipas këtyre gjykatësve, sulmi nuk lidhet domosdoshmërisht me prekjen e shëndetit trupor të viktimës, përkundrazi, mund të realizohet karakteristika edhe me veprimin që nuk ka shkaktuar lëndim trupor ose dëmtim të shëndetit të viktimës dhe veprimi i tillë të jetë realizimi i karakteristikave nga neni 12 paragrafi 1 të LKKRQP-së. Nga ana tjetër, konstatojnë edhe se e padrejta nga kjo dispozitë, neni 12 paragrafi 1 të LKKRQP-së, nuk e konsumon edhe të padrejtën nga neni 130 paragrafi 1 të KP-së. Kjo ndodh sepse ata konsiderojnë se kjo dispozitë i referohet veprimit që është vepra penale lëndimi trupor, që sipas tyre nënkupton të padrejtën më të madhe në lidhje me kundërvajtjen si veprim penal, dhe kryhet nga ai që tjetri do të lëndojë trupin e ndonjë personi ose do ta dëmtojë shëndetin e tij. Gjykata konsideron se kjo vepër ekziston nëse me veprimin e kryerësit është shkaktuar lëndimi trupor ose është dëmtuar shëndeti i viktimës, pavarësisht nga vendi ku është kryer, në vend publik apo jo, për shembull, në shtëpi, objekt, etj. Në këtë rast konkret, gjykata si objekt mbrojtës të këtij inkriminimi e merr integritetin trupor të viktimës, i cili me veprimin e kryerësit prishet ose dëmtohet.

Për shkak të asaj që u tha më lartë, gjykata është e mendimit se nuk mund të konsiderohet si qasje përkatëse me të cilën i akuzuari do të "amnistohej" nga procedura penale, nëse më parë ishte përgjigjur për të njëjtën në procedurën e kundërvajtjes. Në këtë vetëm e ndërlidhin interpretimin "e ngushtë" të dispozitave të parashikuara në Konventë, përkatësisht nenin 4 të Protokollit 7 të Konventës në përputhje me të cilën

konsiderojnë se bëhet fjalë për ndalimin e dënimit të dyfishtë në procedurën penale, dhe duke pasur parasysh, sipas tyre, se bëhet fjalë për persona të dënuar në formën e prerë për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike, ku dënimi është për shkak që në vend publik kryerësit sulmuan fizikisht persona të tjerë, ndërsa jo procedurë penale ku të akuzuarit akuzohen për shkakimin e lëndimeve trupore, që në përputhje me qëndrimin e gjykatave, nuk mund të zbatohet parimi Non bis in idem.

Në grupin e dytë nga ky grup i lëndëve, gjykata, edhe pse e detyruar të merrte parasysh aktgjykimin e kundërvajtjes me të cilin i akuzuari u shpall fajtor dhe i është shqiptuar dënimi monetar, e pranoi pranimin e fajit të të akuzuarit. Në këtë rast, gjykata nuk mori parasysh as parimin res judicata, as Non bis in idem dhe konstatoi se pas inspektimit të zbatuar në lëndën e kundërvajtjes në të cilën u përcaktua se paditësi privat e paraqiti ngjarjen kritike, pas së cilës u ndërmorën masa të mëtejshme që rezultuan me aktgjykimin e së njëjtës gjykatë, ndërsa me të cilën i akuzuari u shpall fajtor për kundërvajtjen e kryer sipas nenit 12 paragrafi 1 të LKKRQP-së dhe u gjykua me dënim monetar - gjobë.

Në tre aktgjykimet e tjera të Gjykatës së Apelit, kjo gjykatë u pajtua plotësisht me interpretimin e gjykatave të shkallës së parë në lidhje me zbatimin e këtyre parimeve, kështu që e mori si të papranueshëm interpretimin e mbrojtjes që ekziston shkella e nenit 7 të LPP-së, sepse, sipas gjykatës, kundërvajtja nga neni 12 paragrafi 1 të LKKRQP-së dhe vepra penale nga neni 130 paragrafi 1 të KP-së janë delikte të kundërligjshme me shkallë të ndryshme të inkriminimit objektiv, mënyra të ndryshme të ekzekutimit (sulm fizik në vend publik - kundërvajtje, përkatësisht lëndim trupor ose dëmtim të shëndetit - vepra penale nga neni 130 paragrafi 1 të KP-së) dhe objekt i ndryshëm i mbrojtjes. Gjykata është e mendimit se me natyrën e përcaktuar ligjërisht të kundërvajtjes nga neni 12 paragrafi 1 të LKKRQP-së, objekti i mbrojtjes është rendi dhe qetësia publike, ndërsa me natyrën e përcaktuar ligjërisht të veprës penale nga neni 130 paragrafi 1 të KP-së, i cili i përket grupit të veprave penale kundër jetës dhe trupit, objekti i mbrojtjes është integriteti trupor i njeriut.

Në mënyrë plotësuese, si argument, Gjykata e Apelit thekson se nuk mund të bëhet fjalë për gjykim të dyfishtë, përkatësisht dënim të dyfishtë për të njëjtën vepër sepse, duke i pasur parasysh faktet e rasteve, bëhet fjalë për dy procedura të ndara, njëra procedurë gjyqësore dhe tjetra është procedurë e mbajtur para organit të kundërvajtjes, Komisionit për Kundërvajtje në MPB-në me objekt të ndryshëm të mbrojtjes. Në bazë të kësaj, nxirret konkluzioni se vendimi i Komisionit për Kundërvajtje nuk është vendim gjyqësor i formës së prerë në kuptim të nenit 7 të LPP-së, si rrjedhojë edhe mosekzistimi i këtij parimi.



---

# KONKLUSIONI



Kur do të shqyrtohen këto vendime përmes prizmit të indikatorëve të parashikuar për analizën e barazimit të vendimeve gjyqësore, mund të konkludohet se të gjitha këto dhjetë lëndë janë të zbatueshme në aspektin e duhur të nenit të caktuar, përkatësisht të njëjtës materie - ekzistimi i procedurës së mëparshme të kundërvajtjes të mbajtur sipas nenit 12 të LKKRQP-së, si dhe më vonë procedurës penale, sipas nenit 130 të KP-së, më saktë kushtet për zbatimin e parimit Non bis in idem.

Në kuadër të grupit të parë të aktgjykimeve, pesë të parat në të cilat zbatohet ky parim, mund të konstatohet se gjykatat thirren dhe përdorin praktikën e GJEDNJ-së, ndërsa vetëm në njërin prej tyre është konstatuar edhe zbatimi, përkatësisht thirrja në praktikën gjyqësore vendase të gjykatave themelore dhe gjykatës së apelit për të njëjtën çështje. Me ç'rast në të gjitha pesë, në mënyrë përkatëse është identifikuar zbatueshmëria e nenit të ligjit, përkatësisht dokumentit ndërkombëtar, në këtë rast Protokollit të Konventës. Në aktgjykimet ku është konstatuar thirrja në "lëndën kryesore", përkatësisht ajo që paraqet lëndën e parë në të cilën bazohet praktika e mëtejshme, bëhet fjalë për lëndën që është pjesë e jurisprudencës së GJEDNJ-së, dhe në mënyrë identike, është lëndë relevante për kontekstin.

Duke i analizuar këto dhjetë vendime, mund të konstatohet se për shkelje të njëjta ose të ngjashme të së drejtës nuk ekziston sanksioni i ngjashëm ose identik. Në fakt, nuk ekziston as veprimi identik brenda të gjitha gjykatave të këtyre dhjetë aktgjykimeve. Ajo që thekson më tej nevojën për veprim të barazuar, duke pasur parasysh këtë parim, është fakti se edhe në kuadër të së njëjtës gjykatë dhe të njëjtit rajon të apelit, nuk haset praktika krejtësisht identike e veprimit. Përkundrazi, bëhet fjalë për ndoshta raste të izoluar gjatë veprimit të gjykatësve individualë, dhe veçanërisht kur bëhet fjalë për rajonin e apelit në Shtip, në të cilën përcaktohet se gjykata e shkallës së dytë ka vendime të ndryshme për të njëjtën çështje. Për këtë rajon të veçantë të apelit, u vu re një praktikë pozitive e të vepruarit në njërin prej këshillave që ka vepruar në procedurën ankimore, por edhe tre negative. Kuptohet, bëhet fjalë për përbërje të ndryshme të këshillit që vendosi në shembullin pozitiv, në krahasim me këshillin identik që vendosi në tre shembujt e tjerë negativë, të cilët merren parasysh në përgatitjen e këtij studimi të rastit.

Nga gjendja e konstatuar kështu, mund të përcaktohet se dallohet logjika juridike sipas së cilës kanë vepruar gjykatat në këto dhjetë vendime të zgjedhura. Ose, për një pjesë të gjykatave, gjendja faktike konkrete duke zbatuar normat juridike prodhon disa veprime juridike për të akuzuarit, ndërsa për një pjesë tjetër të gjykatave, veprime tjera. Kjo në masë të madhe tregon për pasigurinë juridike në sistemin juridik për të gjithë pjesëmarrësit në procedurë penale.

Lidhur me përdorimin e pjesëve / paragrafëve përkatës për citim, si dhe lidhur me teknikat për citimin e vendimeve të GJEDNJ-së, mund të konstatohet se kur bëhet fjalë për citimin e paragrafëve, gjykatat nuk kanë praktikën e futjes së paragrafëve individualë nga aktgjykimet, por ato i fusin pikëpamjet konkrete të kësaj gjykate, pas së

cilës i lidhin me ngjarjen konkrete për të cilën bëhet fjalë. Megjithatë, kur aktgjykimet u referohen vendimeve, gjykatat që kanë zbatuar dhe futur praktikën e GJEDNJ-së, ishin të kujdesshme për ta bërë këtë në përputhje me rregullat e referencimit, përkatësisht citimit të praktikës së kësaj gjykate.


Në përgjithësi, kjo gjendje e konstatuar e veprimit të gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut është e palejueshme dhe e papranueshme, prandaj është e domosdoshme: të miratohet qëndrimi parimor, përkatësisht mendimi juridik parimor nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut me çka do të barazohet qasja dhe veprimi i gjykatave në lidhje me çështjen e sanksionimit të kundërvajtjes, përkatësisht sanksionimit penal në rastet kur bëhet fjalë për vepër identike; ndërhyrja në rregullativën, më saktë në nenin 7 të LPP-së që do të përcaktohet se ndalohet sanksionimi i dyfishtë i të njëjtit person kur ai tashmë është dënuar ose liruar me aktgjykim gjyqësor të formës së prerë, si dhe kur personi ishte sanksionuar ose liruar me vendim përfundimtar të organit tjetër të kundërvajtjes, përkatësisht organit kompetent për shqiptimin e dënimeve.

Lidhur me rekomandimet e përgjithshme në kontekstin e barazimit të vendimeve gjyqësore, pas takimit të zbatuar të punës me gjykatësit nga gjykatat themelore, gjykatat e apelit dhe Gjykatës Supreme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mund të konkludohet se ato janë të mendimit se përmirësimi i cilësisë dhe barazimit të vendimeve gjyqësore do të kontribuonte në përmirësimin e ndjeshëm të funksionimit të përgjithshëm të gjykatave në vend. Ky lloj i metodologjisë dhe analizës do të ishte pikënisje veçanërisht e mirë në përputhje me të cilën mund të vlerësohet cilësia e aktiviteteve të gjykatësve nga Këshilli Gjyqësor në mënyrë që të vlerësojë rregullisht punën e gjykatësve. Kjo ndodh sepse pikërisht krijimi dhe ndjekja e praktikës gjyqësore në një sistem të jurisprudencës është kontrolli rigoroz i arbitraritetit të gjykatësit në fushën e dispozicionit të tij të lirë për të vlerësuar ligjin dhe zbatimin e tij dhe është mekanizëm kontrolli për të mundësuar sigurinë juridike dhe barazinë e qytetarëve para ligjeve. Prandaj, është e domosdoshme edhe për sundimin e së drejtës në një vend.

Nuk ka dyshim për nevojën e standardizimit të caktuar në shkrimin e vendimeve gjyqësore dhe konceptin e tyre, që do të ishte i zbatueshëm për të gjithë. Futja e rregullave të caktuara për strukturimin e vendimeve gjyqësore do të ishte hap pozitiv drejt avancimit të veprimit të gjykatave në punën e tyre. Megjithatë, është evidente se është i nevojshëm avancimi i resurseve njerëzore, përkatësisht kuadrit gjyqësor dhe administrativ që punon në gjykata, dhe i cili është i përfshirë drejtpërdrejt në procesin e përgatitjes dhe hartimit të vendimeve. Në kontekstin e këtij segmenti, me rekomandimin e ekspertëve, imponohet edhe çështja për futjen eventuale të gjykatësit për praktikën gjyqësore brenda gjykatave, i cili si filtër i veçantë do të parafonte vendimin e miratuar, dhe pas vlerësimit paraprak nëse gjatë thirrjes dhe referimit të ndonjë praktike të futur në kuadër të vendimeve vendase ose ndërkombëtare është i zbatueshëm në rastin konkret.

Roli i Gjykatës Supreme në krijimin e praktikës gjyqësore, krijimin e mendimeve juridike, sentencave, etj., është me rëndësi thelbësore në rendin juridik. Prandaj, është e domosdoshme t'i qaset intensivitetit dhe thjeshtësisë të procedurës për miratimin e qëndrimeve dhe mendimeve juridike të rregulluar me Rregulloren e kësaj gjykate, por edhe të inkurajohet roli i saj proaktiv në sistemin juridik, sepse demonstrimi i sigurisë juridike aty ku shfaqen boshllëqe juridike dhe këmbëngulja në çështje të caktuara është mënyra e vetme për të siguruar sundimin e së drejtës dhe zbatimin e barabartë të ligjeve.





# ANEKSI

## BASHKËNGJITJA 1-a: FORMULARI PËR ANALIZËN E CILËSISË SË VENDIMIT GJYQËSOR

Vendimi gjyqësor nr. \_\_\_\_\_

Shifra \_\_\_\_\_

### ANALIZA E VENDIMIT GJYQËSOR TË GJYKATËS THEMELORE

Numri i indikatorit	Indikatorit	Vlerësimi	Koeficienti	Vlera e indikatorit	Shënimi
1	Struktura e vendimit gjyqësor		1		
2	Shqiptimi		2		
3	Koherenca		2		
4	Silogjizmi juridik gjatë subsumcionit / logjikës juridike		3		
5	Shpjegimi i historikut të çështjes		2		
6	Prezantimi i lëndës / çështjes		2		
7	Prezantimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore relevante dhe parimeve juridike		2		
8	Gjendja faktike dhe procedura e provave		1		
9	Shqyrtimi dhe vlerësimi i argumenteve të kundërta		2		
10	Qartësia dhe qëndrueshmëria e arsyetimit		1		
11	Korrektësia gjuhësore dhe gramatikore e tekstit të vendimit gjyqësor		1		

Gjithsej: \_\_\_\_\_

Dhe k=\_\_\_\_\_

Vlerësimi / Shënimi i përgjithshëm;

## BASHKËNGJITJA 1-b: FORMULARI PËR ANALIZËN E CILËSISË SË VENDIMIT GJYQËSOR

Vendimi gjyqësor nr. \_\_\_\_\_

Shifra \_\_\_\_\_

### ANALIZA E VENDIMIT GJYQËSOR TË GJYKATËS SË APELIT

Numri i indikatorit	Indikator	Vlerësimi	Koeficienti	Vlera e indikatorit	Shënimi
4	Silogjizmi juridik gjatë subsumcionit / logjikës juridike		3		
10	Qartësia dhe qëndrueshmëria e arsyetimit		1		
11	Korrekhtësia gjuhësore dhe gramatikore e tekstit të vendimit gjyqësor		1		
12	Udhëzimet e qarta në gjykatën themelore gjatë kthimit të vendimit për rishqyrtim		2		
13	Qartë janë theksuar arsyet për shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë		2		
14	Nëse janë ndryshuar vëllimi ose lartësia e sanksionit, kjo në arsyetim është theksuar qartë pse është bërë ndryshimi, duke e theksuar dallimin në vlerësimin me gjykatën themelore		2		
15	Jepet përgjigje për ankesat		2		
16	Nuk kopjohet gjendja faktike nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë		1		
17	Gjatë ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, vendimi gjyqësor i gjykatës së apelit i ka të gjitha karakteristikat në konstatimin e gjendjes faktike, analizën e provave, theksimin e së drejtës materiale dhe arsyetimin, si dhe për cilindo qoftë vendim gjyqësor të shkallës së parë		2		
18	Vendimet e gjykatës së apelit me të cilat refuzohet ankesa, ka arsyetim vetëm për ato ankesa të cilat paraprakisht nuk janë theksuar dhe për të cilat nuk ka përgjigje në vendimin gjyqësor të shkallës së parë		2		
19	Gjykata e apelit kujdeset për afatin e parashkrimit absolut të lëndës kur duhet të vendos gjykata e shkallës së parë		2		

Gjithsej: \_\_\_\_\_

Dhe k= \_\_\_\_\_

Vlerësimi / Shënimi i përgjithshëm;



